

ANDREA LLUKANI

**KRYEPESHKOP
DAMJAN KOKONESHI**



Tiranë, 2020

ANDREA LLUKANI

**KRYEPESHKOP
DAMJAN KOKONESHI**

Tiranë, 2020

Redaktor: **Prof. Dr. Hajri Shehu**
Konsulente: **Znj. Zografa Kokthi**

PARATHËNIE

Dhimitër Kokoneshi ka lindur më 26 tetor të vitit 1886 në fshatin Llëngë të Pogradecit në një familje atdhetare. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në vijim studioi në shkollën Normale të Manastirit, të cilën e përfundoi më 1906. Pasi u kthye në atdhe filloi veprimtarinë patriotike, duke u lidhur me lëvizjen e Fan Nolit. Në vitin 1925 Dhimitër Kokoneshi përfundoi Seminarin në Janinë të Greqisë dhe pas dy vjetësh më 1927 u dorëzua prift nga Kryeepiskop Visarion Xhuvani. Atë Dhimitër Kokoneshin e emëruan në kishën e Shën Marenës në manastirin e Llëngës.

Veprimtaria e tij patriotike është vlerësuar nga instancat më të larta të vendit. Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me urdhërin “Ylli i kuq”, “Medaljen e kujtimit”, “Medaljen e trimërisë” etj. Gjithashtu nga Këshilli i Qarkut të Korçës i është dhënë titulli i lartë “Qytetar Nderi” me këtë motivacion: *“Për kontributin e tij të shquar në kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve të Qarkut të Korçës si dhe rritjen e Autoqefalisë së Kishës Shqiptare. Pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare dhe i zgjedhur në organet e pushtetit për disa vite rrjesht”*. Dhimitër Kokoneshi u shqua në tri fronte; 1) Ka marrë pjesë aktive në Luftën Nacionalçlirimtare dhe është shquar për trimëri. 2) Ka treguar aftësi organizative në drejtimin e pushtetit vendor. 3) Si primat i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

1-Dhimitër Kokoneshi ka qenë Kryetari i Këshillit Nacionalçlirimtar të Llëngës dhe ka dhënë një kontribut të madh në pajtimin e gjaqeve dhe të hasmërive. Fatmir Gjata në *Ditarin partizan* ka shkruar: *“Në Shën Marenë na priti “Prifti me kobure” patrioti i shquar i Llëngës, i cili kishte marrë të gjitha masat”*. Atë Dhimitër Kokoneshi respektohej në Mokër jo vetëm për trimëri, por edhe për mençurinë e tij. Papu, siç e thërrisnin të gjithë vuri në dispozicion të Lëvizjes Nacionalçlirimtare manastirin e Shën Marenës, i cili u kthye në një qendër të rëndësishme të luftës. Aty u vendos misioni anglez, sepse ishte vendi më i përshtatshëm strategjik. Dhimitër Kokoneshi gjatë Luftës Nacionalçlirimtare është shquar për trimëri. Enver Hoxha në librin “Njerëz të thjeshtë” ka shkruar: *“Dy priftërinjtë kryesorë të Mokrës, Kokoneshi dhe prifti i Podgozhanit, u bënë luftëtarë me armë, partizanë me kamillaf dhe me kobure në brez.”*. Gjithashtu komisar Tuka Jakova ka dëshmuar: *“Prifti me kobure i Llëngës, ndryshe nga fetarët e tjerë e meriton të ketë vendin në radhët e njerëzve të mëdhenj të kohës, si orator, si luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare, i dashur jo vetëm për ata që e njohin dhe ndajnë gëzimet dhe hallet me të, por për gjithë Mokrën, Pogradecin e zonat përreth. Njerëz trima si atë Dhimitër Kokoneshi bënë atë që pas tij populli i kësaj zone të hidhej me besnikëri e guxim nëpër aksione e beteja”*. Papu, e thërrisnin të gjithë, ndërsa shoqëria e ngushtë i thoshte “Prifti me kobure”. Por ai kishte një armë më të fortë së koburja, kishte fjalën dhe besën, prandaj të gjithë e donin dhe e respektonin.

2) Dhimitër Kokoneshit, ndonëse ishte klerik më 30 gusht të vitit 1944 iu besua detyra e Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit, në një situatë shumë të vështirë për vendin. Atë Dhimitër Kokoneshi gjatë viteve që drejtoi Komitetin Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit u shqua për aftësi drejtuese. Me interesimin e tij të drejtpërdrejtë u zgjidhën shumë probleme të kohës. Duke pasur të veshur veladonin e priftit autoritetet e kohës i kërkuan të kryente vetëm një detyrë. Kështu Dhimitër Kokoneshi la kolltukun e butë të Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv dhe përqafoi udhën plot kryqe të klerikut ortodoks. Këtë zgjedhje e bëri për t'i shërbyer më mirë popullit të Pogradecit, të cilët e donin dhe e respektonin pa masë.

3-Me fjetjen e bashkëshortes në vitin 1939 atë Dhimitër Kokoneshi mori ofiqin e arkimandritit. Ndërkohë mori emrin Damiano. Në tetor të vitit 1947 arkimandrit Dhimitër Kokoneshi u dorëzua në gradën episkopale prej Hirësisë së Tij, Paisit dhe Hirësisë së Tij, Kristoforit dhe u emërua Mitropolit i Gjirokastrës, ndërsa më 1966 Hirësia e tij, Damjani u fronëzua mitropolit i Korçës. Me vdekjen e Kryeepiskopit Pais Vodica më 4 mars të vitit 1966 Episkopi i Korcës Damiani u fronëzua Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Emri i tij si Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u përmend për herë të parë gjatë hyrjes së madhe në meshën e datës 13 qershor 1966.

Fortlumtura e Tij, Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Damjan Kokoneshi e përballoi me urtësi mbyllën e kishave. Sekuestrimi i librave fetarë dhe sendeve të shenjta shkaktoi një brengë të madhe në shpirtin e Damjan Kokoneshit. Para se të ndërronte jetë më 18 tetor të vitit 1973 u la amanet fëmijëve që kryqin dhe veshjet klerikale t'ia vinin në varr, sepse pranë tyre do ta ndjente veten gjithnjë në shërbim të Perëndisë. Me fjetjen e tij populli i Pogradecit humbi një nga patriotët e orëve të para të luftës, ndërsa Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë humbi primatin e saj. Ai u largua nga kjo botë dhe tani prehet në paqe pranë Atit qiellor, duke na lënë imazhin e njeriut të drejtë dhe të përkushtuar tek Perëndia.

KREU I PARË

LLËNGA FSHATI I ARUMUNËVE

Llënga është një nga fshatrat e rrethit të Pogradecit. Rreth viteve 1750 fshati Llëngë ka pasur 10.000 banorë. Llënga është zonë e thellë malore, prandaj në një farë mënyre i ka shpëtuar ndikimit të pushtimit osman. Llënga ka pasur gjithashtu shumë mjeshtër zejtarë e tregtarë, të cilët kontribuan në ndërtimin dhe zbukurimin e kishave. Në Llëngë ka ekzistuar kisha e Shën Thanasit¹, e cila është ndërtuar në vitin 1752. Kjo kishë u shkatërrua gjatë luftës italo-greke. Gjithashtu ka qenë edhe kisha e Shën Gjergjit, e cila mendohet se është ndërtuar në vitin 1560. Nëpër fshat kalonte një degë e udhës Egnatia, e cila e lidhte këtë qendër banimi me fshatin Niçë të Voskopojës. Banorët e Llëngës janë arumunë dhe kanë pasur lidhje me banorët e Voskopojës.

Vllehët quhen ndryshe Aromën, fjalë që e përkthyer më shqip ka kuptimin jashtë kufinjve të Rumanisë. Ai që ka përcaktuar këtë emërtim sigurisht që ka qenë një njeri mjaft i ditur. Në gjuhën shqipe është më mirë të thohet Aroman sipas gërmave të alfabeit shqip. Aromanët përfaqësojnë një etni, të cilët jetojnë jashtë Rumanisë. Ata i gjejmë në

¹-Kisha e "Shën Thanasit" gjendet në fshatin Llëngë të Pogradecit. Kisha ka përmasa 12x8.25 metra dhe është bazilikë njënefëshe me tri apside anash. Ikonat e kishës së "Shën Thanasit" janë pikturuar nga Kostandin Shpataraku. Mbi ikonën e madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës gjendet mbishkrimi: Χείρ Κωνσταντίνου ἱερομονάχου καὶ διὰ σπηδρωμή(σ) καὶ πόθου / Νικολάου ἱερεος...ικονόμου...Χ(ριστο)ύ αχγδ (1694). "Dora e jeromonak Kostandinit me kontributin dhe dëshirën e prift Nikollës...ekonomit. Prej Krishtit 1694". Gjithashtu sipas Theofan Popës, Kostandin Shpataraku ka nënshkruar edhe katër ikonat e tjera të mëdha të ikonostasit të kishës: ikonën e Shën Mërisë, ikonën e Joan Pagëzorit, ikonën e Shën Thanasit që është edhe shenjti i kishës, si dhe ikonën e Shën Mitrit. Në faqen e përparme të proskinitarit të kishës së Shën Thanasit gjendet i gdhendur viti 1717. Proskinitari është prej druri të gdhendur rreth 1.50 metra i lartë. Kisha e "Shën Thanasit" është rindërtuar në vitin 1752. Mbi portën perëndimore brenda kishës gjendet mbishkrimi përkatës: Ανεγερθη και ανεστορηθη ο θηος κ(αί) πανσεπτος νσος του εν αγης πατρος ημων Αθανασηου του Μεγαλου Πατριηρχου Αλεξανδρηας / δηα σπηδρομη(τού) κ(αί) υκονομου Νικολαου ηερεος κ(αί) γεροντον Κηρ Δημητρι και ετερος κηρ / Λαζαρου κ(αί) ετερος Γεργι Κηρ Κυονα, κόπου κ(αί)εξόδου παντον τον χριστιανον, ηερουργουντων Γεωργιου ηερεα μιχαηλ ηερεος Λ / αζαρ(ου) δε Γεοργιος, Ποστολη, Κοστα, ταννο, Νικο, Κοστα, τηνα, Αρχηερατεβοντος κυρούου κυρούου Αρσενήου / Βακο. Δηα χηρος καμου ζογράφου ταπηνός Δημητριος ηος Νηκόλαου Ζογραφου ε(κ) κομης χορ(ας) Ληνοτοπη, ηπερετοντον Ζονοβι(ας) μοναχι(σ). "U ngrit dhe u pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i atit tonë ndër shenjtorët, Athanasit të Madh, patrikut të Aleksandrisë, me kontributin dhe të ekonomit prift Nikollës dhe të pleqve zotit Dhimitër, zotit Nikolla, zotit Llazar dhe zotit Kiona, me përprjekjet dhe shpenzimet e të gjithë të krishterëve, të priftërinjve që kryejnë shërbesat e hirshme, prift Gjergjit, prift Mihalit dhe Llazarit, Gjergjit, Postolit, Kostës, Janos, Nikos, Kostës, Tinos. Në kohën e peshkopatit, të peshkopit zotit Arsen Vako. Me dorën time, të piktorit të përvojatur Dhimitrit, birit të Nikollë Zografit, nga katundi Linotopi, që i shërbeu murgeshës Zinovia". Mjeshtër Sotir Tima ka punuar kryqin prej argjendi, i cili përdorej gjatë pagëzimit. Rreth bazamentit të kryqit shkruhet: Τουτο το σταβρου υπαρχι της μονης του αγιου Αθανασιου της πολη-τίας χορα Λανγκα Μαστορας Σοτηρι Τημα. "Ky kryq është i manastirit të shën Thanasit, të qytetit Lunge (Llëngë). Mjeshtër Sotir Tima". Theofan Popa, *Mbishkrime të Kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, mbishkrimet me nr. 20, 23, 25, 78; Andrea Llukani, *Mitropolia e Korçës*, Tiranë 2020, faqe 56-57.

Malet e Pindit të Greqisë, në Shkup, Tiranë, Korçë, Durrës, Fier, Vlorë etj. Fjala Aromën nënkupton kombin Roman, i cili shquhet për virtyte të larta dhe gjuhë moderne. Faktorët e ndryshëm historikë e kanë detyruar këtë komb që të jetojë larg vendit të origjinës².

Arumunët janë shfaqur si fise nomade blektoriale, të cilat me kalimin e kohës kanë kaluar në aktivitete të tjera ekonomike duke u marrë me bujqësi, zejtarë etj. Popullsia arumune është vendosur në zonat rurale të Fierit, Vlorës, Përmetit, Kolonjës, Pogradecit, Korçës, Elbasanit, Beratit, Tiranës, Durrësit etj. Të dhëna rreth numrit të arumunëve të Shqipërisë kemi nga regjistrimi i vitit 1950, ku janë të regjistruar 2.318 banorë. Në regjistrimin e vitit 1955 numri i arumunëve është 4.249 banorë, ndërsa në regjistrimin e vitit 1989 rezultojnë 782 banorë. Sipas një studimi të bërë më 25 tetor 2006, nga INSTAT në bashkëpunim me Drejtorinë e Minoriteteve pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme rezultoi se pakicat kombëtare arumune janë 992 banorë, të cilët përbëjnë 0.03 për qind të minoriteteve aktuale që jetojnë në territorin e Shqipërisë³. Vllahët janë vendosur në fshatrat e Korçës si në Kamenicë, Boboshticë, Mborje, Drenovë, Polenë, në Llëngë të Pogradecit etj. Popullsia vllahe ka edhe në Devoll, Kolonjë, Fier, Sarandë, Vlorë. Në Gjirokastrë vllahët kanë krijuar një fshat, i cili mban emrin “Andon Poçi”. Vllahët i kanë dhënë kombit shumë figura të shquara ndër të cilët mund të përmendim Aleksandër Moisiun, Tefta Tashko Koçon, Sandër Prosin, Prokop Mimën, Nasho Jorgaqin, Dionis Bubani etj⁴.

Banorët e fshatit Llëngë në rrethin e Pogradecit kanë qenë mjeshtër ndërtimi, zejtarë dhe tregarë, të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e manastirit. Në vitin 1752 me kontributin e tyre u ndërtua kisha e Shën Thomait, ndërsa më 1754 kisha e Shën Marenës⁵.

MANASTIRI I LLËNGËS

Manastiri i Llëngës (Fig.1) në rrethin e Pogradecit i është kushtuar Shën Marenës. Rreth viteve 1750 fshati Llëngë ka pasur 10000 banorë, të cilët kanë kontribuar në ndërtimin e manastirit. Banorët e Llëngës janë arumunë dhe kanë pasur lidhje me banorët e Voskopojës. Manastiri zë një sipërfaqe të madhe toke, e cila fillon nga livadhet e Mujazeve. Kisha (Fig.2) mendohet se është ndërtuar në vitin 1660 dhe është rindërtuar më 1754. Kisha është e stilit bazilikë njënefëshe me përmasa 11.85x6.75 metra. Kisha është e pikturuar me afreske, ku më i spikaturit është ai që i kushtohet martirizimit të Shën Marenës. Afresket (Fig.3) janë pikturuar në vitin 1754 nga Kostandin Shpataraku. Mbi

²-Tahir Gaxhenji, *Vllahët, bij të kombit të zhdukur Roman*, Sot, 27 dhjetor 2003, faqe 12-13.

³-Tedi Blushi, *Shifrat zyrtare të minoriteteve*, Standard, 11 nëntor 2006, faqe 17.

⁴-Fiqiri Shahinllari, *Arumunët janë bërë pjesë e pandarë e popullit shqiptar*, Republika, 15 nëntor 2006, faqe 11.

⁵-Gjergji Gusho, *Mbi përhapjen e krishtëritimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit*, Pogradec 2000, faqe 109-110.

portën perëndimore të naosit brenda kishës është shkruar: +Ανηστωρίθη ο Θεῖος ουτος καί πάνσεπτος ναός τῆς αγίας μεγάλωμάρτυρας τού Χ(ριστο)ύ Μα / ρίνις δια βοηθίας όλων τών / χριστιανών καί ρουφετίων τών κριστάδων καί ραυτά / δων καί μακελίων καί καρβανιών μικρών καί μεγάλων τών εύρισκομενων έν τη πολητεία Λά / γκα. Κόπου δέ καί εξώδου τού εύλαβεστάτου Γερασίμου ιέρεως καί επιτροπητής τῆς ταγίας μον(ής) ταυτης. Επιστα / σία δέ καί συνδρωμής τού έντιμωτάτου προεδρου Γέωργίου τού Νικόλα Μάνη ομού καί τών σηνακου / λουθων αυτών γερόντων έν ω ησίν τά ονόματα ομου καί του αρχιερατεύοντος καί τών ιε / ρατευώντων θέμενα είς τόν θεῖον ναόν τού αγίου Γεωργίου ανάμεσων τῆς πολιτείας είς δύλωσ / ιν τών αναγι(γ)ν(ω)σκόντων. Ετελ(εθιώθη έν έτη από Χ(ριστο)υ Α Ψ Ν Δ (=1754) μηνι οκτωμβρίω Β. “U pikturua ky tempull hyjnor dhe i gjithnderuar i dëshmoresh së madhe të Krishtit, shën Marinës, me ndihmën e të gjithë të krishterëve, të esnafëve, të mjeshtërve, të rrobaqepësve, të kasapëve dhe të karvaneve të vegjël e të mëdhenj, që gjenden në qytetin Llëngë, me përpjekjet dhe shpenzimet e të shumëdevotshmit prift Gerasimit dhe mbikqyrës të këtij manastiri të shenjtë, me kujdesin dhe kontributin e të shumëndershmit, kryetarit Gjergj Nikollë Manit, së bashku me pleqtë që e pasonin atë, emrat e të cilëve së bashku dhe të peshkopit dhe të priftërinjve gjenden në tempullin hyjnor të Shën Gjergjit, në mes të qytetit, si të ekspozuara për ata që do ti lexojnë. U përfundua në vitin prej Krishtit 1754, muaji tetor 2”⁶.

Me anën e një mbishkrimi tjetër mësojmë së kunga e kishës është pikturuar me shpenzimet e Kostë Nirrës: + Τούτω τό θεῖον καί ιερόν βύμα ανηστωρίθη δια δάπα / νης τού Κώστη είου τού Μάρκου Μήρρα είς ψυχικήν αυτου σώτηρίαν καί τών γοναίων. “Kjo kungë hyjnore dhe e hirshme e pikturuar me shpenzimet e Kostës, birit të Mark Nirrës, për shpëtimin e shpirtit të tij dhe të prindërve”⁷.

Mbishkrimi është shkruar me dorën e Kostandin Shpatarakut dhe gjendet në faqen e murit lindor, mbi nikën e prothesit. Në portën perëndimore të narteksit të kishës është shkruar: + Είσελεύμαι είς τόν οίκον σου, προσκυνήσω πρόσ ναόν (τόν) αγιον σου. / έν φόβω σου. Κύριε, οδήγησόν με έν τή δικαιοσύνη σου, ένε / κα τόν έχθρών μου κατεύθυνον ενώπιόν σου τήν οδόν μου. “Do të hyj në shtëpinë tënde, do të adhuroj në kishën e shenjtëruar tënden, me frikën tënde, zot, më hiq udhën në drejtësinë tënde për punë të armiqve të mi. Drejto përpara teje udhën time”⁸.

Gjithashtu peneli i Kostandin Shpatarakut⁹ ka pikturuar një pjesë të ikonave që gjenden në ikonostasin e kishës. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet në ikonën e

⁶-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 34, faqe 62-63.

⁷-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 35, faqe 63-64.

⁸-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 36, faqe 64.

⁹-Kostandin Shpataraku e ka origjinën nga Shpati i Elbasanit. Kjo vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet në ikonën e "Krishtit Pandokrator" në kishën e "Anargjendëve të Shenjtë Kozma e Damjan" (qimitirit) në manastirin e "Shën Pjetrit" në Vithkuq të Korçës. Në të shkruhet: Χείρ Κωνσταντήνου ιερο / διακόνου έκ Σπαθείας. / έτη από Χ(ριστο)ύ α ψ μ η (=1748) "Dora e Jerodhjakon Kostandinit nga Shpati, viti prej Krishtit 1748". Datat e lindjes dhe të vdekjes së Shpatarakut nuk dihen. Kostandin Shpataraku ka qenë ikonograf i talentuar në pikturimin e ikonave dhe afreskeve. Kostandin Shpataraku ka pikturuar ikonat e

madhe të Krishtit në ikonostasin e kishës: Απο Χ(ριστο)ύ Α Ψ Ν Ε (=1755). / Χείρ Κωνσταντήνου ί(ε)ροδιακόνου. “Prej Krishtit 1755, dora e jerothiakon Kostandinit”¹⁰. Gjithashtu ikonografi Shpataraku në ikonën e Shën Thanasit ka lënë këtë mbishkrim: Δέησις τού δούλου τού Θεού Γεωργίου Μάνη. “Lutje e shërbëtorit të Perëndisë Gjergj Manit”¹¹. Në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar është ekspozuar ikona Kryqëzimi i Krishtit¹², me përmasat 37x28 cm dhe numër inventari 3652.

Gjatë vizitës së një delegacioni zyrtar në Maqedoninë e Veriut pamë në Galerinë e Ikonave të Ohrit, ikonën "Shën Marina me skena" (Fig.4) të ikonografit Kostandin Shpataraku. Ikona ka përmasat 92.5 x 60.5 dhe etiketa shkruan se e ka origjinën nga kisha "Nëna e Zotit Peribleptos" në Ohër¹³. Duke kërkuar në arkivin personal gjeta një artikull të studiuesit Moikom Zeqo¹⁴, i cili është i mendimit se ikona bënte pjesë në repertorin e ikonave të manastirit të "Shën Marinës" në Llëngë të Pogradecit. Në kërkimet e

manastirit të "Shën Gjon Vladimirit" në Elbasan, por me djegien e kishës më 14 mars 1944 ato u shkrumuan. Ikona e parë e pikturuar prej tij daton në vitin 1739. Aktiviteti i Shpatarakut në pikturimin e ikonave është mjaft i dendur. Peneli i Kostandin Shpatarakut ka pikturuar një pjesë të ikonave që gjenden në ikonostasin e kishës së "Shën Marenës" në Llëngë të Pogradecit. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi në ikonën e madhe të "Krishtit Pandokrator". Në vitin 1767 ka pikturuar 16 ikonat e ikonostasis të kishës së "Shën e Premtes" në Kavajë. Në ikonën e madhe të "Krishtit Pandokrator" është shkruar: +Χείρ Κωνσταντίνου ίεροδιακόνου εκ Σπαθ(ίας) έτος από Χριστού α ψ ξ ζ (=1767) “Dora e jerothiakon Kostandinit, nga Shpati, viti prej Krishtit 1767”. Si për ironi të fatit ikonostasi me gjithë ikonat e pikturuara nga Kostandin Shpataraku u zhduk nga kisha para disa vitesh. Aktualisht ikonat e pikturuara nga Kostandin Shpataraku janë në muzetë e Shqipërisë. Theofan Popa, *Kostandin Shpataraku, piktori shqiptar i shekullit XVIII*, Nëntori, Nr. 3, 1965; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 349, faqe 199; Theofan Popa, *Piktor Kostandini prej Shpati*, Buletin për shkencat shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 211-214; Theofan Popa, *Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII*, Ngjallja, dhjetor 1995, faqe 8; Ylli Drishti, *Kostandin Shpataraku, piktori i artit mesjetar shqiptar*, Tiranë 1992, faqe 28.

¹⁰-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 32, faqe 62.

¹¹-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 33, faqe 62.

¹²-Ikona “Kryqëzimi i Krishtit” është realizuar nga ikonografi Kostandin Shpataraku. Ajo është marrë nga kisha e Shën Marenës në Llëngë të Pogradecit. Në qendër të ikonës është Krishti i kryqëzuar. Ai paraqitet i pajetë, me sy të mbyllur dhe me kokën të anuar nga e djathta. Kryqi është vendosur në shkëmbinjtë e Golgothasë. Në një zgavër poshtë tij, ikonografi paraqet një kafkë, mbi të cilën pikon gjaku i Krishtit. Kjo është kafka e Adamit, i cili sipas traditës, ka vdekur dhe është varrosur aty. Mbishkrimi në tabelën sipër kryqit I.N.B.I. do të thotë: “Jisu Nazareti Mbret i Judenjve”. Majtas kryqit qëndron Hyjlindësja, së bashku me gratë miropurëse, ndërsa në anën tjetër të Kryqit paraqitet apostull Joani dhe pas tij, kryeqindëshi Longin me veshje ushtarake, që drejtoi kryqëzimin. Prania e tij në ikonë është mjaft domethënëse. Ai është dëshmitar i kryqëzimit. Longini ka qenë pranë kryqit dhe e ka dëgjuar Krishtin të lutej: “O Atë, fali ata, sepse s’dinë se ç’bëjnë!”. Në ikonë paraqiten muret e qytetit të Jerusalemit. Dorian Koçi, Andrea Llukani, *Pavijoni i ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar*, (dorëshkrim i pabotuar), Tiranë 2018, faqe 48-49; Melsi Labi, Dorian Koçi, *Udhërrëfyes i Muzeut Historik Kombëtar*, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë 2014, faqe 60; Melsi Labi, *Guidebook of National Historical Museum of Albania*, Tirana 2016, page 132-133.

¹³-Milco Georgievski, *Icon Galery-Ohrid*, Ohrid 1999, page 96; *Ohrid Macedonia, City Guide*, Publisher: Municipality of Ohrid, page 28-30.

¹⁴-Në artikull studiuesi Zeqo shkruan:-Ikona e Shën Marinës për mendimin tim duhet të jetë bërë nga piktori për manastirin e Shën Marinës në Mokër. Më pas duhet të jetë transportuar në kishën e Shën Klementit në Ohër. Këtë e them e vërtetohet katërcipërisht nga fakti që disa nga kompozimet në miniaturë të kësaj ikone gjenden në afreskat e manastirit të kësaj shenjtojeje në Mokër. Moikom Zeqo, *Një ikonë e re e panjohur e Konstandin Shpatarakut*, Ekskluzive, nr. 20, dhjetor 2001, faqe 111-112.

mëtejshme në një artikull të shkruar nga kuratori i Galerisë së Ikonave në Ohër, studiuesi Milco Georgievski rezulton se ikona është blerë në vitin 1962 nga Naum Koteli me shumën e 15 mijë dinarëve¹⁵. Ky fakt vërtetohet nga akti i blerjes që disponon Galeria e Ikonave në Ohër, por nuk thuhet se ku e ka blerë dhe nga kush e ka blerë Naum Koteli ikonën e "Shën Marinës me skena".

Pjesa tjetër e ikonave është pikturuar nga Kostandin Jeromonaku¹⁶. Ndër to mund të përmendim ikonën Krishti Pandokrator¹⁷, e cila aktualisht është në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë.

¹⁵-Milco Georgievski, *St. Marina of Antioch and her representations on t̄eo icons from the Icon Gallery in Ohrid*, Academia.edu.

¹⁶-Kostandin Jeromonaku i përkasin rreth 100 ikona, në harkun kohor 1604-1728. Emrin e tij e gjejmë në ikonat e kishave të Voskopojës, të manastirit të "Shën Gjon Vladimirit" në Elbasan, të kishës së manastirit të "Shën Pjetrit dhe Pavlit" në Vithkuq, të kishës "Burimi Jetëdhënës" në Korçë etj. Ikonat e ikonostasit të kishës "Fjetja e Hyjllindëses" në Voskopojë janë pikturuar prej dorës së Kostandin Jeromonakut. Në vitin 1725 Kostandin Jeromonaku ka pikturuar ikonën e "Shën Gjergjit" dhe ikonën e "Shën Dhimitrit" në kishën e "Shën Kollit" në Voskopojë. Dy ikona të kishës së manastirit të "Shën Gjon Vladimirit" në Elbasan kanë nënshkrimin e tij. Ikonat "Krishtit Pandokrator" dhe "Shën Mëria me Krishtin" aktualisht janë ekspozuar në pavijonin e ikonave pasbizantine të Muzeut Historik Kombëtar. Në vitin 1694 Kostandin Jeromonaku ka pikturuar ikonën "Krishti Pandokrator", në kishën e manastirit të Shën Marenës në Llëngë të Pogradecit, e cila aktualisht është në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë. Kostandin Jeromonaku ka pikturuar disa nga ikonat e kishës së manastirit të "Shën Pjetrit dhe Pavlit" në Vithkuq të Korçës. Gjatë viteve që ushtroi veprimtarinë e tij Kostandin Jeromonaku ka treguar mjeshtëri të lartë, kulturë artistike dhe përgatitje të mirë teologjike. Të gjitha këto karakteristika, por duke u nisur edhe nga mbiemri Jeromonaku vërtetojnë se ai është formuar si ikonograf në një atelie të dëgjuar. Dorian Koçi, *Thesare kulturore nga Voskopoja në Muzeun Historik Kombëtar*, botuar në: *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, faqe 404; Ylli Drishti, *Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri*, Davinci, Tiranë, 2003, faqe 30; Ylli Drishti, *The Byzantine and Post-Byzantine Icons in Albania*, Davinci, Tirana, 2003, page 30; Eugenia Drakopoulou, *Icons from the Orthodox Communities of Albania*, Thessaloniki, 2006, page 120-123; Ευγενία Δρακοπούλου, *Εικόνες από τις ορθόδοξες κοινοτητες της Αλβανίας*, Θεσσαλονίκη, 2006, σελ. 120-123.

¹⁷-Ikona "Krishti Pandokrator" e ka origjinën nga kisha e Shën Marenës në manastirin e Llëngës në rrethin e Pogradecit. Ka përmasat 97x63.5 cm dhe numër inventari 7488. Ikona është pikturuar nga Kostandin Jeromonaku në vitin 1694. IC XC në pjesën e sipërme të ikonës janë shkronjat e para të emrit Jisu Krisht në greqisht. Të përkthyer në shqip, mund të shkruhen JS KR. Shkronjat në kurrorën O Ω N kanë kuptimin "AI QË ËSHTË". Përkthyer në shqip, mund të shkruhen "JAM". Ky është emri që Zoti i tregoi Moisiut në Malin e Horebit. Në ikonë Krishti Pandokrator paraqitet me lavdinë e Tij qiellore. Krishti Pandokrator është ulur në një fron tëmadh të zbuluar me ornamente të shumta bimore. Ai është veshur me rroba të kuqe dhe me tunikën ngjyrë blu. Stihari i Krishtit është i stolisur me motive floreale. Në mes ka lidhur një rrip ngjyrë ari. Krishti bekon me dorën e djathtë dhe mban ungjillin në dorën e majtë. Ungjilli i Shenjtë tregon se Jisu Krishti është mësues për gjithë njerëzimin. Në të është shkruar: Μαθετε απ'εμου, οτι πρως εμi και ταπεινος τη καρδια και ευρησετε αναπαυσιν ταις ψυχαις υμων, ο γαρ ζυγος μου χρηστος και το φορτιον μου ελαφρον εστιν. " Mësoni nga unë, sepse jam zemërbutë dhe i përlulur nga zemra, dhe do të gjeni çlodhje për shpirtat tuaj. Sepse zgjedha ime është e butë dhe barra ime është e lehtë!" (Mateu 11, 29-30). Në pjesën e poshtme të ikonës, nën fronin ku është ulur Krishti është shkruar: ΧΕΙΡ ΚΩΝΣΤΑΝΤΙΝΟΥ (ΙΕΡΟΜΟΝΑΧΟΥ) (...) ΣΗΝΔΡΟΜΗ Κ(ΑΙ) ΠΟΘΟΥ ΝΙΚΟΛΑΟΥ ΙΕΡΕΟΣ Κ(ΑΙ) ΕΙΚΟΝΟΜΟΥ (...) ΑΠΟ (...)Χ(ΡΙΣΤ)ΟΥ ΑΧΖΑ. "Dora e Kostandin Jeromonakut. Me shpenzimet dhe dhimbjen e priftit dhe ikonomit Nikolla. Viti 1694". Mbishkrimi është shkruar në tre pjesë ndërmjet këmbëve të Krishtit dhe fatkeqësisht ka dëmtime në shumë vende. Më e rëndësishme është se ka shpëtuar viti 1694 dhe nënshkrimi i piktorit ikonograf. Ylli Drishti, *Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri*, Davinci, Tiranë, 2003, faqe 30; Ylli Drishti, *The Byzantine and Post-Byzantine Icons in Albania*, Davinci, Tirana, 2003, page 30; Eugenia Drakopoulou, *Icons from the Orthodox Communities of Albania*,

Mbi gurin arkitra të portës jugore të kishës gjendet një mbishkrim, i cili tregon kohën e ndërtimit të strehës së hajatit jugor: ΗΚΟΔΟΜΗΣΕ Ο Π(Α)ΠΙΑ ΣΩΤΗΡΙΣ 1832. “E ndërtoi at Sotiri 1832”¹⁸.

Mbrapa kishës gjenden konakët e vjetër të manastirit. Manastiri i Llëngës në rrethin e Pogradecit në vitin 1948 është shpallur monument kulture¹⁹. Me prishjen e kishave në vitin 1967 në mjediset e manastirit u vendos një repart ushtarak dhe vite më vonë zyrat e ndërmarrjes pyjore²⁰.

PANAIRI I SHËN MARENËS

E kremtja e Shën Marenës është më 17 korrik, por me kalendarin e vjetër i bie që të festohet më 30 korrik. Në panairin (Fig.5) që zhvillohet me këtë rast vijnë shumë besimtarë, kryesisht njerëz që kanë probleme shëndetësore dhe kalojnë natën në kishë me besimin që Shën Marena do t’u japë shërim. Në pjesën perëndimore të kishës ndodhet një burim me ujë të kthjellët, me të cilin besimtarët lajnë fytyrën dhe mbushin shishe me ajazëm, ndërsa në pjesën juglindore të manastirit gjendet shpella e Shën Marenës. Sipas një tradite të vjetër thuhet se në këtë shpellë gjeti strehë Shën Marena, kur e përndiqnin të pabesët.

Në kremtimet e panairit të vitit 1930 në manastirin e Llëngës, mori pjesë edhe Kryepikopi i asaj kohe Imzot Visarion Xhuvani. Në revistën Kisha Kombëtare - Tiranë – 17.08.1930 është shkruar artikulli “*Një kremtim madhështor në manastirin e Shën Marenës*”: -Udhëtimi për në Shën Marenë qe madhështor. Me kryehirësin e Tij Kryepiskopin në krye ish një grup klerikësh, të Përnderçmit Stavrofor Ikonom Josif prej Korçë, Igumeni i Manastirit Shën Ilija të Hoçishtit Stavrofor Minai, Zavendësi i Mitropolitit të Pogradecit Arhimandrit Grigori, At Thomai famulltar i Tiranës, At Joani Famulltar i katundit Potkozhan, At Serafimi i katundit Pleshisht, At Joani i katundit Tushemisht, At Panajoti i katundit Niçë dhe At Prokopi, Ikonom Dhimitri, igumeni i Manastirit dhe famulltar i Llëngës, si dhe sekretar i Kryepiskopit Z.Taq Bici.

Më 28 Korrik u kthyem në katundin Potkozhan, ku na u bë një pritje shumë e mirë. Me gjith që qe pak vonë, u-bë një Tedeum në Kishë ku Kryehirësia e Tij mbajti një fjalë mbi dashurinë e vllazërinë. Mbrëmanet u pritme në shtëpi të dy priftrave dhe ne z. Petrika. Darka ishte pregatitur shumë bukur dhe ndër popullin vërehej një gëzim shpirtëror për këtë rasje ekstraordinare të vizitës kryepiskopale.

Thessaloniki, 2006, page 120-123; Ευγενία Δρακοπούλου, Εικόνες από τις ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας, Θεσσαλονίκη, 2006, σελ. 120-123.

¹⁸-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 51, faqe 68.

¹⁹-*Trashëgimia Kulturore akte ligjore dhe nënljgore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2003, faqe 79.

²⁰-Gjergji Gusho, *Mbi përhapjen e krishtëritimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit*, Pogradec 2000, faqe 111-118.

Të nesërmen kortezhi arrijti lart në Manastirin, ku u këndua një Tedeum. Pas tedeumit u bë, sipas zakonit hierarhik, zgjedhja e Igumenit dhe si i tillë u-zgjodh i ndriçmi Arhimandrit Grigor, zavendës Metropolitit në Pogradec. Kryehirësia e Tij Kryepiskopi spiegoi detyrat igumenale dhe pas një prehjeje të shkurtë u këndua mbrëmësorja. Të nesërmen mesha u bë me madhështi dhe imponante në oborrin e Kishës, mbasi kisha është tepër e vogël dhe gjindja ishte e shumtë, më tepër se 2000 shpirt. Të gjitha këndimet e ditës u bënë shqip, se vetë i palodhuri Kryepiskop i përkthevi udhës, kudo që rrinim për çlodhje, pjesët e posaçme për meshtimin e asaj dite. Në meshë u dorëzua në Anagnost z. Qirill Potkozhan. Përgjithësisht ceremonia bëri një përshtypje të papërshkrueshme në popullin e këtushëm se s'kish parë kurrë në këto vënde të ktilla ceremoni. Në meshë kënduan me melodi të këndëshme psaltët e Pogradecit z. H Kërkhalliu dhe S. Ambrozi. Pas meshe me ceremoni të madhe u bë "Litania" ku gjithë populli orthodhoks thërrisnin "Lavdi o Zot mbi ty lavdi".

Me këtë rast nuk harrojmë pa përmendur dhe Kryetarin e Komunës z. Jorgaq Semini, si dhe kapterin z. Ymer Kadriu dhe rreshterin z. Selfo Mahmuti, të cilët bashkë me xhandarët na bënë nder të math dhe për këtë i falënderojmë. Gjithashtu falënderojmë dhe Këshillin Igumenial të Shën Marenës z. Llambi Basho dhe Jorgji At Kostandin si dhe Igumenin At Dhimitër Kokoneshin, që nuk kursyen mundimet për të kënaqur neve dhe gjithë popullin që u ndodh në këtë Panagjir të paharrueshëm, duke ardhur nga katundet për rreth, pa ndryshim feje, që prej dy dit larg, dhe duke kaluar nëpër ato udhë të rrezikshme të krahinave të Mokrës, Gorës dhe Yerstës. Fjala Panagjirike e Imzot Visarionit u dëgjua me interesim të madh prej popullit²¹.

Klerikët që kanë shërbyer në kishën e Shën Marenës kanë qenë vendas nga fshati Llëngë: papa Jorgji, papa Kostandin Kokoneshi, papa Qirill Gegprifti, atë Dhimitër Kokoneshi etj.

SHËN MARENA

Shën Marena ishte nga Antiokia i Pisidisë një qytet në Azinë e Vogël dhe jetoi në kohën e perandorit Klaudi II. E ëma e saj kishte vdekur pak ditë pasi e kishte lindur kështu që ajo mbeti nën kujdesin e babait të vet i cili quhej Edes dhe ishte jo vetëm pagan por edhe prift i idhujve. Ky ia besoi vajzën që ta rriste e t'ia edukonte një gruaje tjetër e cila banonte në një çiflig jashtë qytetit. Marena e vogël kishte trashëguar prej nënës së saj cilësi të mira, cilësi që me anën e gruas që e rriti u shtuan dhe u thelluan. Ajo grua kishte një ndërgjegje të pastër dhe të zhvilluar. Bashkë me këtë grua u katekizhua dhe u bë e krishterë edhe Marena e vogël e cila në këtë kohë ishte pothuaj 12 vjeç. Babait të saj Marena e vogël nuk i tregoi gjë për këtë punë. Ajo falej rregullisht dhe me zemër, kungohej sa herë që e donte nevoja dhe pasi më përpara pendohej dhe rrëfehej. Si u bë 14

²¹-Panagjiristi, *Një kremtim madhështor në manastirin e Shën Marenës*, Kisha Kombëtare - Tiranë - 17.08.1930.

vjeç e pa të arsyeshme se nuk duhej t'ia fshihte më këtë punë babait, kështu që një ditë kur erdhi ai për ta parë i tha se si u bë e krishterë dhe e luti që edhe ai ta pranonte këtë fe. Kur e dëgjoi Edesi këtë gjë u trondit pa masë. Pasi me qortime, me lutje dhe kërcënime nuk mundi ta kthente Marenën përsëri në fenë pagane iku duke e mallkuar dhe duke i thënë se kjo sjellje e kishte dëshpëruar pa masë dhe kishte bërë që të mos e njihje më për bijë.

Ca muaj më vonë hynë në Antioki qeveritari Olivri i shoqëruar edhe nga një kompani kalorësie. Rastësisht ky pa në rrugë Marenën, bukuria e se cilës ishte jashtë çdo përshkrimi dhe bëri që qeveritari të shtangej. Të nesërmen dërgoi disa njerëz në shtëpinë e Marenës që t'i thonin të përgatitej shpejt e shpejt se e donte qeveritari. Dhe ajo si u fal me zemër te Zoti, u nis pas të dërguarve. Olivri kur e pa mbeti mëse i gëzuar. Ai i tha Marenës se kishte për qëllim ta merrte për grua. Shën Marena nuk pranoi dhe deklaroi se ishte e krishterë. Olivri u mundua ta bindte Marenën duke zënë nëpër gojë një nga një tërë nderimet, kënaqësitë që do të kishte po të bëhej gruaja e tij. Por kur pa se ajo nuk ndërronte mendim por qëndronte e pathyer në besimin e Krishtit, urdhëroi ta çonin në burg. Por me një urdhër tjetër të fshehtë Marena u çua në vendin e vdekjes. Ajo tha lutjen e saj të fundit në tokë dhe pastaj xhelati duke i prerë kryet e kurorëzoi me kurorën e dëshmores. Kujtimin e saj e kremtojmë më 17 korrik²².

ATË DHIMITËR KOKONESHI FIGURË E SHQUAR E KOMBIT

Atë Dhimitër Kokoneshi (Fig.1) ka lindur më 26 tetor të vitit 1886 në fshatin Llëngë të Pogradecit në një familje atdhetare. Gjyshi i Dhimitrit Tun Kokoneshi ka qenë udhëheqës i çetës së Mokrës dhe ka luftuar me heroizëm kundër pushtuesve turq. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në vijim studioi në shkollën Normale të Manastirit, të cilën e përfundoi më 1906 me rezultate të mira. Pasi u kthye në atdhe filloi veprimtarinë patriotike duke u lidhur me lëvizjen e Fan Nolit. Atë Dhimitër Kokoneshi ka marrë pjesë në revolucionin demokratiko-borgjez të qershorit të vitit 1924, i cili kryesohej nga Kryeepiskop Fan Noli. Në këtë kohë filloi punë si psalt në kishën e Llëngës. Në vitin 1925 Dhimitër Kokoneshi ka përfunduar Seminarin në Janinë të Greqisë.

Atë Dhimitër Kokoneshi ka qenë prift i martuar dhe ka pasur katër fëmijë dy djem dhe dy vajza. Bashkëshortët Dhimitër dhe Kostandina (Fig.2) kanë lindur Anastasin, Todin, Ksanthipin dhe Lirinë. Djemtë e tij Anastasi dhe Todi kanë marrë pjesë në luftë. Gjithashtu Atë Dhimitri dhe Kostandina kanë lënë katërmbëdhjetë nipër dhe

²²-*Jetë shenjtorësh, Nr. 6*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1996, faqe 44-48.

mbesa. Ksanthipi u martua në Tiranë në vitin 1936. Anastasi u martua me Krisavgjinë nga Voskopoja. Todi u martua me Marikën në Pogradec dhe Liria u martua në Gjirokastër me Jorgon. Pasardhësit e tij janë krenarë për gjyshin e tyre patriot dhe atdhedashës.

Në vitin 1927 Dhimitër Kokoneshi u dorëzua prift nga Kryepiskop Visarion Xhuvani. Atë Dhimitër Kokoneshin e emëruan në kishën e Shën Marenës në manastirin e Llëngës. Më 31 korrik të vitit 1927 Atë Dhimitër Kokoneshi ka celebruar meshën e parë në kishën e Shën Marenës²³.

PRIFTI ME KOBURE

Më datën 7 prill të vitit 1939, që përkonte me të premtën e zezë, Italia fshiste sulmoi Shqipërinë. Okupacionin fashist atë Dhimitër Kokoneshi e priti me indinjatë të thellë. Menjëherë thirri banorët e Llëngës, Jallës dhe Zgallës. Në mbledhje u vendos të dërgonin një përfaqësi në komunë për të kërkuar armë. Përfaqësia me priftin Kokoneshi në krye marshoi drejt qytetit të Pogradecit për të protestuar. Më një nëntor të vitit 1942 banorët e Llëngës u grumbulluan në sheshin e fshatit. Të parët mbërritën Kokoneshët me atë Dhimitrin në krye, më pas Tonajt, Divjakësit, Blidot, Ngulajt, Roka, Gjoka, Bardhollarët etj. Kështu është mbledhur Llënga sa herë që atdheu ka qenë në rrezik. Bijtë e saj kanë rrëmbyer armët për të luftuar pushtuesit e huaj. Atë Dhimitri në fjalën e tij tha: *“Shqipëria po digjet. Shqipëria po përgjaket. Për ne vetëm ajo është e shenjtë. Liria e saj. S’ka kuptim jeta jonë pa lirinë e Shqipërisë. Kështu na e lanë amanet gjyshërit, baballarët tanë, ata burrat e rreptë, ndjesë paçin ata që nuk janë, por që u ndriçon shpirti edhe sot e kësaj dite. Më mirë një sahat në liri se sa tërë jetën të poshtëruar, të gjunjësuar e në robëri. Armiku do të na shkatërrojë shtëpitë, do të na mbushë kraharorët me plumba. Shqipëria na thërret e ne i përgjigjemi”*. Pasi folën edhe të tjerë u zgjodh këshilli i fshatit: atë Dhimitër Kokoneshi, kryetar, Naum Nguli sekretar, Jorgji Blido, Llazi Koliçi, Pandi Ruvina, Goi Xhorbo, Andrea Ndoti, Sotir Dhimitri, anëtarë. Të nesërmen u bë mbledhja e parë e këshillit në shtëpinë e atë Dhimitër Kokoneshit²⁴.

Më 15 gusht të vitit 1943 në Llëngë komisari Tuka Jakova bëri një takim me banorët e fshatit ku ndër të tjera tha: *“Shtëpitë e Llëngës, njerëzit trima të saj na hapën dyert, na kanë shoqëruar e mjekuar partizanët nga një bazë në tjetrën. Nga Llënga janë regjistruar nëpër formacionet e UÇN mbi 60 partizanë. Prifti me kobure i Llëngës ndryshe nga fetarët e tjerë e meriton të ketë vendin në radhët e njerëzve të mëdhenj të kohës, si orator, si luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare, i dashur jo vetëm për ata që e njohin dhe ndajnë gëzimet dhe hallet me të, por për gjithë Mokrën, Pogradecin e*

²³-Arumunët e Shqipërisë, Histori dhe dokumente për figura të shquara historike, botim i Shoqatës Arumunët e Shqipërisë.

²⁴-At Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e fesë dhe kombit, Mokra, shkurt- mars 2001, faqe 4-5.

zonat përreth. Njerëz trima si Atë Dhimitër Kokoneshi bënë atë që pas tij populli i kësaj zone të hidhej me besnikëri e guxim nëpër aksione e beteja”

Në zonën e thellë të Mokrës, në pikën më strategjike, në Shën Marenë në muajin tetor të vitit 1943, patrioti i shquar atë Dhimitër Kokoneshi mbledhi luftëtarët e Luftës Nacionalçlirimtare të Llëngës. Fjalimi i tij entuziasmoi bashkëfshatarët: “Burrat e mënçur të Llëngës 193 vjet më parë ndërtnuan me kontributin e tyre këtë manastir me ndërtesa madhështore. Ata ia përkushtuan Shën Marenës, sepse ajo ka qenë një vajzë e mirë, besnike dhe e zellshme në bësimin tek Krishti. Edhe ne bijtë e nipër e stërgjyshër të atyre burrave të mençur kemi vënë në jetë një amanet që na kanë lënë. E mbajtëm dhe e mbrojtëm si sytë e ballit manastirin, këtë kështjellë kombëtare, ndërsa sot unë mendoj të bëjmë atë që është më e madhe: Manastirin e Shën Marenës ta vëmë në dispozicion të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Qelat e murgjërve ti kthejmë në spital partizan për ata bij të popullit që po luftojnë për çlirimin e vendit. Armiku dhe shërbëtorët e tij kanë intensifikuar sulmet kundër nesh, po na vrasin, plagosin, po na çfarosin bagëtinë etj. Këtej e tutje këtu do të zhvillohen dhe mbledhjet me këshillat jo vetëm të Mokrës, por edhe të Gramshit, Gorës e Oparit, sepse Shën Marena është vend strategjik”.

Fatmir Gjata në Ditarin partizan ka shkruar: “*Më 19 tetor të vitit 1943 mbërritëm në Llëngë. Fshat mikpritës. Që aty shkuam në manastirin e Shën Marenës, ku na priti Kryetari i Këshillit dhe komandanti i njësitit Atë Dhimitër Kokoneshi. Aty u bisedua për luftën, për nevojat materiale të ushtrisë, për municione etj. Qëndruam në Llëngë, në roje duke pritur që të riorganizohej Batalioni i Mokrës. Partizanët qëndruan nëpër shtëpitë e llëngasve. Qëndruam atje dy ditë sa të riorganizohej Batalioni i Mokrës. Në Shën Marenë “Prifti me kobure” patrioti i shquar i Llëngës kishte marrë të gjitha masat për fjetje dhe për ngrënie”. Atë Dhimitër Kokoneshi respektohej në Mokër jo vetëm për trimëri, por edhe për mençurinë e tij. Kjo bëri që t’i shkonin pas jo vetëm farë e fisi i tij, por gjithë Llëngasit, Joellsit e Zgallesit nëpër aksionet e luftimet që kryheshin në zonën e Mokrës. Papu, siç e thërrisnin të gjithë vuri në dispozicion të Lëvizjes Nacionalçlirimtare manastirin e Shën Marenës, i cili u kthye në një qendër të rëndësishme të luftës. Aty u vendos misioni anglez, sepse ishte vendi më i përshtatshëm strategjik. Mujazat e Shën Marenës u kthyen si fushë për zbarkimin e materialeve në ndihmë të luftës. Misioni anglez në Llëngë ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me Kryetarin e Këshillit të Llëngës atë Dhimitër Kokoneshin²⁵.*

Dhimitër Kokoneshi gjatë Luftës Nacionalçlirimtare është shquar për trimëri. Enver Hoxha në librin “Njerëz të thjeshtë” ka shkruar: “*Dy priftërinjtë kryesorë të Mokrës, Kokoneshi dhe prifti i Podgozhanit, u bënë luftëtarë me armë, partizanë me kamillaf dhe me kobure në brez.*”. Dhimitri i Shën Marenës shkonte në kishë me kobure në brez. Kur kryente shërbesat fetare, dikush ia mbante koburen tek dera e kishës. Si mbaronte shërbesën, dilte dhe e ngjeshte përsëri koburen në brez. Prifti patriot mori pjesë në shumë aksione që u zhvilluan në zonën e Mokrës.

²⁵ -Pandë Sotir Konomi, *At Dhimitër Kokoneshi-figurë e shquar e fesë dhe e kombit*, Kushtrim Brezash.

KONTRIBUTI I DHIMITËR KOKONESHIT SI DREJTUES I PUSHTETIT VENDOR

Dhimitër Kokoneshit, ndonëse ishte klerik më 30 gusht të vitit 1944 iu besua detyra e kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit, në një situatë shumë të vështirë për vendin. (Fig.3) Shqipëria sapo kishte dalë nga lufta dhe duhej rindërtuar. Në atë kohë ai këshillonte vartësit e tij: “Duhet të mendojmë dhe të sigurojmë sa më shpejt strehën e qytetit dhe të fshatrave të bëra shkumb. Duhet të mendojmë edhe për copën e bukës për popullin që vuan urie, edhe për veshjen e njerëzve, edhe për shkollën, punishtet. Gjersa fituam dhe morëm pushtetin me aq sakrifica e derdhëm dhe gjak, duhet ta çojmë Shqipërinë patjetër përpara për të mirën e lumturinë e popullit”. Me interesimin e drejtpërdrejtë të kryetarit të ri filluan reformat. U krijuan shërbimet komunale, u ngritën ndërmarrjet e furnizimit të popullsisë, filloi shfrytëzimi i minierave, u themelua ndërmarrja e përpunimit të drurit etj. Në janar të vitit 1945 filloi viti i rregullt shkollor në qytet dhe në 42 fshatra të rrethit të Pogradecit. Në vitin 1946 u ngrit Shtëpia e Kulturës, e cila gjallëroi jetën kulturore të qytetit të Pogradecit. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv i kushtoi rëndësi të veçantë zejtarisë, duke krijuar tetë kooperativa artizanale, për këpucarët, rrobaqepësit etj.

Atë Dhimitër Kokoneshi gjatë viteve që drejtoi Komitetin Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit u shqua për aftësi drejtuese. Me interesimin e tij të drejtpërdrejtë u zgjidhën shumë probleme të kohës. Duke pasur të veshur veladonin e priftit autoritetet e kohës i kërkuan të kryente vetëm një detyrë. Kështu Dhimitër Kokoneshi la kolltukun e butë të kryetarit të Komitetit Ekzekutiv dhe përqafoi udhën plot kryqe të klerikut ortodoks. Këtë zgjedhje e bëri për t’i shërbyer më mirë popullit të Pogradecit, të cilët e donin dhe e respektonin pa masë²⁶.

Me fjetjen e bashkëshortes në vitin 1939 atë Dhimitër Kokoneshi mori ofiqin e arkimandritit. Ndërkohë mori emrin Damiano. Veprimtaria e tij patriotike është vlerësuar nga instancat më të larta të vendit. Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me urdhërin “Ylli i kuq”, “Medaljen e kujtimit”, “Medaljen e trimërisë” etj. Gjithashtu nga Këshilli i Qarkut të Korçës i është dhënë titulli i lartë “Qytetar Nderi” (Fig.4) me këtë motivacion: *“Për kontributin e tij të shquar në kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve të Qarkut të Korçës si dhe rritjen e Autoqefalisë së Kishës Shqiptare. Pjesëmarrës në Luftën Nacional-çlirimtare dhe i zgjedhur në organet e pushtetit për disa vite rrjeshit”*.

²⁶-At Dhimitër Kokoneshi, *figurë e shquar e fesë dhe kombit*, Mokra, fletëpalosje e botuar me sponsorizimin e Znj. Zografa Kokhit, mbesës së atë Dhimitër Kokoneshit.

KREU I DYTË

LIDHJA E TEOLOGËVE DHE SEMINARISTËVE

Në korrik të vitit 1945 u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it, e cila zgjodhi si kryetar të saj teologun Theofan Popa²⁷. (Fig.1) Sekretar i lidhjes u zgjodh teologu Dhimitër Beduli²⁸. (Fig.2) Anëtarë të lidhjes qënë: Petro Doçi²⁹,

²⁷-Theofan Popa ka lindur më 3 nëntor të vitit 1914, në lagjen Kala të Elbasanit në një familje zanatçinjshe. Pasi përfundoi shkollën fillore "Kostandin Kristoforidhi", me ndërhyrjen e atë Josif Mihalit mundi të sigurojë një të drejtë studimi për në Seminarin Teologjik "Joan Teologu" në Manastir. Me mbarimin e seminarit në vitin 1936 u kthye në Shqipëri dhe pas një viti me mbështetjen e Kryepeshkopit Visarion Xhuvani mundi të shkonte për të ndjekur studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Universitetit Kapodistria të Athinës, në vitin akademik 1937-1938, me bursë nga fondacioni Jovan Banga. Ndërkohë në Shqipëri ndodhën ndryshime të mëdha përsa i përket organizimit kishtar. Më 12 prill 1937, Patriarkana Ekumenike shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u zgjodh Kristofor Kisi. Sapo përfundoi vitin e parë të fakultetit, Theofani mori një letër nga Kryepeshkop Kisi, me anën e së cilës i thuhej se duhej t'i ndërpriste studimet në Athinë, për t'i vazhduar në Kolegjin Anglikan "Ngjallja e Krishtit" në Londër. Pasi qëndroi vetëm disa muaj në Londër (gusht-tetor 1938) u kthye në Athinë për të vazhduar studimet, të cilat i përfundoi në vitin 1941. U kthye në atdhe më 1942 dhe filloi punë në Liceun e Korçës si profesor i gjuhës latine. Më vonë u transferua në Tiranë ku punoi si predikues dhe artikullshkrues pranë kryesisë së kishës. Theofani botonte një buletin dyjavor me predikimet e të dielave, i cili u dërgohej kishave ortodokse të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë, 2019, faqe 13; Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 286; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 278-279; Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.

²⁸-Dhimitër Beduli (1914-1996) ka lindur më 1914 në Skore të Pogonit në rrethin e Gjirokastrës. Në vitin 1930 pasi përfundoi gjimnazin në Athinë, u nis për studime teologjike në Rumani, të cilat i përfundoi në vitin 1934. Përveç studimeve teologjike në seminarin e Besarabisë, Beduli u specializua edhe në Muzikën Bizantine. Sapo u kthye nga Rumania në vitin 1934 punoi si pedagog dhe gjatë viteve 1935-1944 u emërua drejtor i seminarit "Apostull Pavli" në Tiranë. Me mbylljen e Seminarit në vitin 1945 Beduli filloi punë në Drejtorinë Qendrore të Oficinave në Durrës dhe në vijim shef plani në Uzinën Mekanike në Tiranë. Mund të themi se që nga viti 1945 deri në vitin 1967 kur u prishën kishat, janë plot 22 vjet, gjatë të cilave Beduli i talentuar ka qënë i mënjanuar. Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 66; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 288.

²⁹-Petro Doçi ka lindur në Elbasan, më 20.07.1909. Në vitin 1928 siguroi një bursë nga Visarion Xhuvani për të ndjekur studimet teologjike në Seminarin e Manastirit (Bitolës). Gjatë viteve të seminarit ishte e detyruar mësimi i një vegle muzikore. Petro Doçi zgjodhi mandolinën. Seminarin e përfundoi në vitin 1934. Në vijim u kthye në Elbasan ku ka punuar si mësues. Më 19 shtator 1937 emërohet nga Kryepeshkop Kristofor Kisi si predicator në kishat e Elbasanit. Më 1935 u martua me Vasillon. Më 25 shtator 1938 u dorëzua dhjakon nga Imzot Kristofor Kisi. Më pas është emëruar Protodhiakon i Kryesisë së Kishës. Më pas e gjejmë Drejtor Përgjegjës i revistës "Jeta Kristiane". Në vitin 1950 u dorëzua prift. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme kishtare brenda dhe jashtë vendit. Me mbylljen e kishave më 1967 Petro Doçi ka

(Fig.3) Vlash Semini³⁰, Anastas Duka, Vangjel Popa, Petro Frashëri, Vlash Nushi³¹, (Fig.4) Sotir Kanxheri etj., të gjithë njerëz të shkolluar nëpër seminare dhe shkolla teologjike brenda ose jashtë vendit. Këta kishin qenë pjesë aktive e kishës, por Këshilli Ekonomik për mungesë fondesh disa prej tyre i kishte shkarkuar nga detyra dhe ata qenë të detyruar të punonin ku të mundnin që të siguronin jetesën. Teologët dhe seminaristët e larguar nga kisha e ndienin veten të shpërfillur dhe për këtë bënë me faj Kryesinë e Kishës. Njeri prej tyre Anastas Duka³² ishte mjaft kritik ndaj Kryesisë së Kishës, sepse teologët dhe seminaristët qenë larguar nga kisha dhe qenë punësuar në administratën shtetërore.

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it hartoi statutin, rregulloren dhe ligjëroi vulën. Simboli bazë në vulën e Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve qenë dy duar të shtrënguara, duke mbajtur një kryq. Rreth këtij simboli shkruhej Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të Kishës Ortodokse. Qendra e lidhjes ishte në Tiranë, por u krijuan degë nëpër rrethe si në Durrës, Korçë, Shkodër etj. Me vendimin e Gjykatës së

punuar në një pikë karburanti. Vite më vonë ka punuar roje në Laboratorin Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës etj. Petro Doçi ka vdekur më 27 dhjetor 1983. Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006, faqe 10-31.

³⁰-Vlash Semini ka lindur në qytetin e Kavajës më 1906. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Bukuresht, Vlashi u kthye në Tiranë, ku ka shërbyer si kujdestar dhe psalt në Kishën e Shën Prokopit. Vlash Semini ka botuar shumë artikuj teologjik në shtypin periodik të K.O.A.Sh-it. Ai vdiq më 24 qershor të vitit 1989. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296.

³¹-Vlash Nushi ka lindur në Tiranë më 8 shkurt 1914. Pasi përfundoi shkollën fillore ka punuar pranë babait, i cili kishte një dyqan të vogël në Shën Vlash. Në vitet 1931-1935 përfundoi seminarin Apostull Pavli në Tiranë. Në vijim ka punuar si psalt në Tiranë, ndërsa më 1937 ka punuar si mësues feje. Në vitin 1940 ka punuar në Ministrinë e Ekonomisë në Tiranë. Gjatë viteve 1954-1959, Vlash Nushi ka punuar si referent i pasurive kishtare. Vlashi ka botuar disa artikuj në revistën "Predikimi". Kur u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it më një korrik të vitit 1945 Vlash Nushi ka qenë i zgjedhur në kryesinë e lidhjes. Vlash Nushi ka vdekur në vitin 1981. Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 46-48; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 25; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951, fl. 34-36.

³²-Anastas Duka ka lindur më 10 maj 1921 në Sheper të Gjirokastrës. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje ka bërë tre vjet shkolë të mesme në Gjirokastrë dhe pesë vjet në Tiranë ku ka përfunduar Liceun më 1942. Gjatë viteve të qëndrimit në Tiranë ka kryer seminarin Apostull Pavli ku ka qenë bursist. Në prill të vitit 1945 ka qenë në varësi të Kishës Ortodokse, duke punuar në vende të ndryshme. Gjatë muajve prill-gusht 1945 ka punuar në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, prej andej për nëntë muaj ka punuar në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Në qershor 1946 ka punuar për disa muaj në manastirin e Ardenicës. Në periudhën dhjetor 1946 deri në mars 1947 ka punuar në Pogradec. Prej andej ka qenë në dispozicion të Kryesisë së Kishës në Zyrën e Llogarisë. Në janar 1948 ka shërbyer në Fier si predikues dhe mësues katekizmi. Në prill 1948 ka punuar në Shën Vlash të Durrësit dhe prej andej ka shkuar në vendlindje në Sheper, në pritje të një detyre të re nga Kryesia e Kishës. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja nr. 1470, viti 1951, fl.3-4.

Tiranës datë 19 shtator të vitit 1945, Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it u ligjëruea zyrtarisht³³.

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it pikëpamjet e saj i shfaqti në broshurën me titull "Ç'është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë". (Fig.5) Qëllimi kryesor i kësaj Lidhjeje ishte që të kontribuonte në përparimin dhe lartësimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, me qëllimin e vetëm që ajo të ruante integritetin e saj dhe të mos përshtatej me rrethanat që i diktonte sistemi. Në kryesinë e lidhjes u zgjodhën: Sotir Kanxheri³⁴, Dhimitër Beduli, Ilia Stavre, Vlash Semini dhe Arkile Kondi. Kryesia e lidhjes më 24 shtator 1945 i shkroi një letër³⁵ Sinodit të Shenjtë, me anë të së cilës i parashtronte synimet e saj. Sinodi i Shenjtë më 18 korrik 1945 iu përgjigj, se do ta studionte përmbajtjen e letrës, gjë që acaroi edhe më shumë marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të lidhjes dhe kryesisë së kishës. Anëtarët e Lidhjes fajësonin Kryepiskopin Kristofor për gjendjen e mjeruar në të cilën ishte katandisur Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Qëllimi i tyre ishte të merrnin në dorë situatën, duke tërhequr pas vetes klerikët dhe besimtarët. Teologët e seminaristët e rinj qenë njerëz të arsimuar dhe synonin të detyronin Kryepiskopin Kristofor që të përfshiheshin brenda strukturave të kishës. Në mbledhjen e datës 20 tetor 1945 Sinodi i Shenjtë refuzoi të njihnte Statutin e Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve. Madje u vunë si kusht se nëse dëshironin njohjen e Lidhjes duhej ti kërkonin falje kryesisë së kishës për letrat me tone të ashpra që i kishin dërguar. Sinodi i Shenjtë ngarkoi episkopin e Gjirokastrës, Imzot Irineun tu komunikonte anëtarëve të Lidhjes vendimin e sinodit³⁶. Në këto kushte teologët dhe seminaristët, por edhe kryesia e kishës vendosën të ulin tonet dhe të gjejnë gjuhën e përbashkët.

Në fund të dhjetorit Kryepiskopi Kristofor Kisi u bëri të ditur anëtarëve të Lidhjes së do ti merrte parasysht kërkesat e tyre, nëse ata do të tregonin respekt ndaj kryesisë së kishës³⁷. Më 31 dhjetor 1945 Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve vendosi

³³-Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 46-48; Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019, faqe 14; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 351.

³⁴-Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka lindur në qytetin e Korçës më 10 nëntor të vitit 1922. Në vitet 1932-1935 ndoqi Liceun Francez të Korçës dhe në vijim kreu Seminarin "Apostull Pavli" në Tiranë. Në vitin 1950 u dorëzua në dhjakon, ndërsa në vitin 1965 mori ofiqin e kryedhjakonit. Kanxheri me zërin e tij kumbues i lëçiste aq bukur ungjillin, paqësoret dhe himnet e Liturgjisë Hyjnore. Më 27 mars 2000 u zhvillua shërbesa e varrimit për kryedhjakon Sotir Kanxherin në Kishën e Ungjillëzimit në Tiranë. Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka dhënë kontributin e tij në financat e kishës. *Fjeti Kryedhjakoni Sotir Kanxheri*, Ngjallja, prill 2000, faqe 3; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 161-162; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 13-14.

³⁵-Disa nga pikat e letrës qenë: punësimi i teologëve dhe i seminaristëve, vendosja e njerëzve të ndershëm në Këshillin Ekonomik të kishës dhe në Këshillin Mikst, transparenca mbi shpenzimet e kishës etj.

³⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 42.

³⁷-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.

ti dërgojë një letër tjetër Kryepiskopit Kisi, me anën e së cilës e sqaronin se do të qenë bij të bindur të kishës³⁸. Madje ata ndryshuan edhe disa pika në statutin e tyre, duke pranuar autoritetin e kryesisë së kishës dhe premtorin se çdo gjë do të zhvillohej sipas statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas kësaj, Kisi ishte i gatshëm ta njihte Lidhjen e Teologëve dhe Seminaristëve për të shmangur përçarjen në gjirin e kishës³⁹. (Fig.6)

DAMJAN KOKONESHI NË MOSKË

Më 8 maj të vitit 1947 u mbledh Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në kryesinë e Kryehirësisë së tij, Kryepiskopit Kristofor Kisi, Mitropolitit të Beratit Imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marko. Qëllimi i mbledhjes së sinodit ishte dërgimi i një delegacioni kishtar në përgjigje të ftesës së Patrikut të Moskës dhe gjithë Rusisë Aleksej me rastin e 500 vjetorit të shpalljes së autoqefalisë së Kishës së Rusisë⁴⁰. Në ftesën e Patrikut Aleksej drejtuar Kristofor Kisit thuhej se periudha më e përshtatshme që fundi i shtatorit. Fillimisht u vendos që në përbërje të delegacionit të qenë: 1-Kristofor Kisi, Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. 2-Ikonom Dhimitër Kokoneshi, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Pogradecit. 3-Atë Petro Doçi, famullitar i komunitetit ortodoks të Tiranës dhe 4-Atë Lllazar Popoviç, famullitar i komunitetit malazez të Shkodrës. Kjo ishte përbërja e delegacionit të lartë kishtar sipas shkresës që Kryepiskopi Kristofor i dërgonte më 11.VI.1947 Ministrisë së Punëve të Jashtme⁴¹. Por keqësimi i shëndetit të Kristofor Kisit e bëri të pamundur pjesëmarrjen e tij.

Kështu përbërja e delegacionit sipas shkresës së Kryesisë së Sinodit të Shenjtë Nr. 375 datë 15 dhjetor 1947 ishte: 1-Arkimandrit Paskal Vodica, drejtues administrativ i Episkopatës së Korçës, shef i delegacionit. 2-Ikonom Dhimitër Kokoneshi dhe 3-Ikonom Lllazar Popoviç⁴². Delegacioni zyrtar (Fig.7) i Kishës Ortodokse të Shqipërisë qëndroi 18 ditë në Bashkimin Sovjetik. Gjatë ditëve të qëndrimit delegacioni shqiptar vizitoi Moskën, Leningradin dhe Kievin. Delegacioni shqiptar (Fig.8) pati një pritje të përzemërt nga patriku Aleksej. Kryetari e delegacionit arkimandrit Paskal Vodica⁴³ dhe patriku

³⁸-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 43.

³⁹-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 52.

⁴⁰-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947, fl.2.

⁴¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.11.

⁴²-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.32.

⁴³-Paskal Vodica ka përkrahur pa rezerva Luftën Nacionalçlirimtare deri në çlirimin e plotë të atdheut. Ndonëse në moshë të thyer Paskal Vodica u zgjodh anëtar i Këshillit Nacional-çlirimtar të Qarkut të Korçës. Madje në Kongresin e Përmetit arkimandrit Paskal Vodica u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional-çlirimtar. Duke parë veprimtarinë e tij atdhetare okupatorët fashistë e arrestuan dhe e internuan rreth një vit në Bari të Italisë. Pasi u lirua nga internimi, më 28 nëntor të vitit

Aleksej⁴⁴ folën për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Të dy kishin qenë partizanë. Edhe anëtari tjetër i delegacionit Dhimitër Kokoneshi ka marrë pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare⁴⁵. Delegacioni i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë bëri disa vizita nëpër monumentet historike të Moskës. Ata vizituan Sheshin e Kuq, kishën Uspjesku, (Fig.9) në të cilën kurorëzoheshin carët e Rusisë, mauzoleumin e Leninit, muzeun e Stalingradit⁴⁶ (Fig.10) etj. Gjatë një interviste (Fig.11) që dha në selinë e Patriarkanës së Rusisë, kryetari i delegacionit Paskal Vodica ndër të tjera tha: "Lidhja e kishës sonë me kishën ruse na pëlqen dhe e dëshirojmë me gjithë shpirt. Kisha jonë është e lidhur me kishën ruse dhe si një fëmijë i vogël të mbahet në pëqi të mëmës së madhe, e

1939 në kishën e Ersekës celebroi një tedeum, gjatë të cilit mbajti një fjalim me ndjenja të larta patriotike. Për meritat e tij patriotike gjatë luftës është nderuar me "Urdhërin e Flamurit" dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Pas çlirimit të vendit u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja 1333, viti 1966; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 130.

⁴⁴-Patriku Aleksej ka qëndruar i rrethuar bashkë me popullin për 90 ditë në Leningrad, ku ka marrë pjesë aktive në luftë dhe ka mbajtur lart moralin e popullit rus. Për këtë kontribut të çmuar në rrethimin e Leningradit ai është dekoruar nga instancat më të lartat të shtetit rus.

⁴⁵-Dhimitër Kokoneshi e vuri manastirin e Shën Marenës në dispozicion të Lëvizjes Nacional-çlirimtare. Ai ka luftuar me armë në dorë deri në çlirimin e plotë të vendit. Fatmir Gjata në Ditarin partizan ka shkruar: "*Më 19 tetor të vitit 1943 mbërritëm në Llëngë. Fshat mikpritës. Që aty shkuam në manastirin e Shën Marenës, ku na priti Kryetari i Këshillit dhe komandanti i njësitit atë Dhimitër Kokoneshi. Qëndruam atje dy ditë sa të riorganizoheshin Batalioni i Mokrës. Në Shën Marenë "Prifti me kobure" patrioti i shquar i Llëngës kishte marrë të gjitha masat për fjetje dhe për ngrënie". Manastiri i Shën Marenës u kthye në një qendër të rëndësishme të luftës. Aty u vendos misioni anglez, sepse ishte vendi më i përshtatshëm strategjik. Gjithashtu Enver Hoxha në librin "Njerëz të thjeshtë" ka shkruar: "*Dy priftërinjtë kryesorë të Mokrës, Kokoneshi dhe prifti i Podgozhanit, u bënë luftëtarë me armë, partizanë me kamillaf dhe me kobure në brez". Kokoneshi i Shën Marenës shkante në kishë me kobure në brez. Kur kryente shërbesat fetare, dikush ia mbante koburen tek dera e kishës. Si mbaronte shërbesën, dilte dhe e ngjeshte përsëri koburen në brez. Prifti patriot mori pjesë në shumë aksione që u zhvilluan në zonën e Mokrës. Për meritat e tij gjatë Luftës Nacional-çlirimtare Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka nderuar Dhimitër Kokoneshin me urdhërin "Ylli i kuq" dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 3-4; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 132; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 68-69.**

⁴⁶-Anëtari i delegacionit Dhimitër Kokoneshi në shënimet e tij ka shkruar: "Nëpër stendat e muzeut të Stalingradit pashë madhështinë e betejave që janë zhvilluar prej 12 nëntorit 1942 deri më 21 shkurt 1943. Gjatë betejave qenë asgjësuar 32 divizione dhe tre brigada të armikut. Populli rus është shquar për krenarinë kombëtare, e cila u shfaq dukshëm gjatë viteve të luftës së Dytë Botërore. Në Stalingrad heroizmi nuk ishte një ngjarje individuale, por një fakt kolektiv. Nëpër stendat e muzeut u njoha se si popullsia mori pjesë gjallërisht në Betejën e Stalingradit, se si gratë ishin të gatshme të zinin vendin e shokëve të rënë, se si shtëpitë dhe rrugët e tyre u kthyen në fortesa e transe, se si luftuan brenda godinave gjysmë të shkatërruara, kat më kat e portë më portë. Pashë në qytezën e ndërtuar rishtazi, ruhej si një kujtim i përjetshëm i betejës gjiganteske të Stalingradit, shtëpia e rreshterit Pavllov, ku sovjetikët u mbrojtën për dyqind ditë nga sulmet e gjermanëve. Në Stalingrad unë pashë fotot e tri gjigandëve të aleancës së Luftës së Dytë Botërore, Stalin, Rusvelt dhe Çërçill". Llazi Tona, *Në labirintet e monumenteve kulturore historike të përbotshme*, Mokra, prill 2009, faqe 7.

cila do ta përkëdhelë e do ta dirizhojë dhe do e organizojë siç di vetë"⁴⁷. Me rastin e kthimit të delegacionit nga Moska më 8 korrik 1948 (Fig.12) në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë u mbajt një referat nga kryetari i delegacionit Paskal Vodica, i cili foli për përshtypjet e vizitës⁴⁸.

DORËZIMI I PASKAL VODICËS DHE SHKARKIMI I KRISTOFOR KISIT

Në kuadër të forcimit të miqësisë ndërmjet dy kishave tona rusët premtuan se në momentin e përshtatshëm do të dërgonin një delegacion të lartë kishtar për të vizituar Shqipërinë⁴⁹. Patriku Aleksej i Moskës i dërgoi një letër Kristofor Kisit, (Fig.13) me anën e së cilës theksonte se kisha ruse do të ndihmonte kishën shqiptare. Me fjalën ndihmë nënkuptohej mbështetja që do të jepte për krijimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në koordinim me Patriarkanën e Moskës, Ministria e Drejtësisë i kërkoi Kristofor Kisit, të përgatiste procedurat e hirotonisjes së dy episkopëve për dioqezat e Gjirokastrës dhe të Korçës. Kisi pranoi dhe sipas tij, kisha kishte nevojë të ngutshme vetëm për një episkop, ndërsa për të dytin priste puna. Delegacioni rus mbërriti në Shqipëri më 14 prill 1948. Ai përbëhej nga Kryepiskopi Nestor, protoprezviteri Pjetër Fillonov dhe atë Mihail Zjernov. Më 18 prill 1948 Nestori bashkë me Kristofor Kisin hirotonisën në gradën episkopale Paskal Vodicën në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë. Pas dorëzimit si Mitropolit i Korçës, Paskal Vodica mori emrin Paisi⁵⁰. Kandidatura e Paskal Vodicës nuk ishte shqyrtuar më parë në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë dhe ishte antikanonike, pasi ai nuk plotësonte kriterin e arsimimit⁵¹ dhe të beqarisë, ndonëse prej vitesh kishte mbetur i ve. Procedura e dorëzimit të Paskal Vodicës ishte e rregullt, pasi që hirotonisur nga dy peshkopë kanonikë, Nestorit dhe Kristoforit.

Më 5 qershor 1948, në mbledhjen e Byrosë Politike, ndër të tjera diktatori Enver Hoxha diskutoi edhe për Kristofor Kisin, duke e cilësuar atë si agjent të perëndimit, që nuk dëshironte afrimin e Kishës Autodokse Autoqefale të Shqipërisë me Patriarkanën e

⁴⁷-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 218, viti 1948, fl. 2-4.

⁴⁸-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 32.

⁴⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 23-24.

⁵⁰-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 30.

⁵¹-Në nenin 17 të Statutit të vitit 1929 theksohet: "Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorëzohen, përveç cilësive të Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanonet e Kishës, si dhe të kenë mbaruar një Fakultet Theologjie. Në rast nevojë, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, mund të dorëzohet Peshkop edhe ay që ka diplomë fakulteti drejtësie, filologjie ose të një Seminari Orthodhoks në gradë Liceu". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 195.

Moskës. Hoxha pretendonte se Kisi gjatë vizitës së delegacionit rus, ishte përpjekur të lidhej me Legatën franceze në Tiranë, që të merrte udhëzime nga Perëndimi. Pas kësaj akuze false diktatori Enver Hoxha mendonte se Kisi duhej mënjanuar nga drejtimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë⁵².

Në muajin korrik 1948, autoritetet shtetërore i sugjeruan Kryepiskopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlunturisë së Tij, Kristofor Kisit të tërhiqej nga administrimi i kishës, ndonëse në nenin 19 të statutit të vitit 1929 thuhej: “*Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dhioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut*”⁵³. Ndonëse Kristofor Kisi mbeti formalisht në krye të kishës, udhëzimet do ti jepte Pasi me ndihmën e sekretarit të përgjithshëm Niko Çanes. Madje, Pasi iu besua edhe mbajtja e vulës së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë⁵⁴. Në fakt sipas nenit 22 të statutit, Sinodi i Shenjtë kishte të drejtën ta shkarkonte Kryepiskopin, për shkak të moshës së thyer ose problemeve shëndetësore, të cilat nuk e linin të përmbushte detyrën⁵⁵.

Pasi kishte nevojë për mbështetje brenda sinodit, prandaj kërkoi që anëtarë të sinodit të qenë edhe Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi⁵⁶, (Fig.14) i cili në atë kohë drejtonte dioqezën e Beratit (Fig.15) dhe Ikonom Aristotel Strato⁵⁷, që administronte dioqezën e Gjirokastrës. Nga ana kanonike si Kokoneshi ashtu edhe Strato nuk mund të qenë anëtarë të sinodit, sepse nuk e patën marrë ende gradën episkopale. Ndërkohë që më 5 korrik 1949, Ministria e Drejtësisë e thirri Kisin dhe e urdhëroi të mbledhë sinodin.

⁵²-Sipas studiuesit Artan Hoxha lidhjet e Kristofor Kisit me ministrin e Francës në Shqipëri, Guy Menant qenë të forta. Megjithatë organet e Sigurimit të Shtetit nuk raportojnë për asnjë lloj kontakti mes tyre gjatë muajit prill 1948, që përkonte me vizitën e delegacionit rus. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 105; Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 140, Dosja Nr. 60, fleta 51.

⁵³-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929, Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

⁵⁴-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi Nr. 536, Dosja Nr. 232, fl.115.

⁵⁵-Në nenin 22 të statutit është shkruar: “Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t’i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos. Po Sinodhi mundet edhe *motu proprio* të çfaqë mejtimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodhit vetë, dy prej të sëmurit dhe një prej Drejtorisë së P. të Shëndetësisë. Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk japin dorëheqjen brenda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodhi me një herë emëron një ndihmës Peshkop, i cili merr përsipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët të deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonitë e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin asnjë pjesë aktive në administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërinë e tyre, ata japin dorëheqjen duke marrë nga arka e përgjithshme e Kishës një shpërbllim të përmuajshëm për Kryepeshkopin gjashtëqind franga ari, dhe për Peshkopët katërqind fr. ar”. *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 197.

⁵⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 5.

⁵⁷-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 8.

Kristofor Kisi u kërkoi autoriteteve shtetërore, që në përbërje të sinodit të ishte edhe Irine Banushi, por ata iu përgjigjën me diplomaci “do ta studiojmë si rast”. Duke mbetur i vetëm përballë klerikëve, që qenë caktuar nga regjimi, Kristofor Kisi më 9 korrik 1949 njohu Kokoneshin dhe Straton si anëtarë të sinodit⁵⁸. Duke patur në dorë Sinodin e Shenjtë, regjimi do të niste zbatimin e një politike të re brenda kishës me mbështetës të bindur ndaj kryesisë së kishës dhe të pushtetit.

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë⁵⁹ të 25 gushtit 1949 Kryeepiskop Kristofor Kisin e shkarkuan me akuza nga më banalet sikur kishte ngrënë dhe pirë në një çanak me pushtuesin, sikur mbante veshët çuar nga deti, duke pritur shpëtimin nga jashtë, sikur kishte bërë punë armiqësore të rrezikshme për të diskretituar pushtetin popullor etj⁶⁰. Në kohën që u shkarkua Kisi, Irine Banushi deklaroi se procedura e ndjekur ishte antikanonike, sepse duke u bazuar në nenin 21 të statutit ku thuhet: “*Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëve dhe i Ikonomit të Madh Mitrofor bëhet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinare dhe për arsye ekstraordinare.*”⁶¹ Kisin e shkarkuan në mënyrë antikanonike dhe nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por e mënjanuan dhe e izoluan në kishën e Shën Prokopit në Tiranë. Sinodi u mor edhe me problemin e Irine Banushit. (Fig.16) Më 31 gusht 1949 Irineu u emërua peshkop ndihmës i kryesisë së kishës, por nuk u lejua që të drejtonte ndonjë dioqezë.

Pas shkarkimit së Kristofor Kisit i erdhi radha Paisi Vodicës⁶². Më 25 gusht 1949 Paisi Vodica (Fig.17) u shpall Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të

⁵⁸-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 116.

⁵⁹-Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë qenë Paisi Vodica me cilësinë e kryetarit, Dhimitër Kokoneshi, anëtar, Aristotel Strato anëtar, Niko Çane, anëtar. Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku nuk mori pjesë për arsye shëndetësore.

⁶⁰-Disa nga akuzat sipas Paisit ndaj Kisit qenë: “Kristofor Kisi me origjinë nga Berati, por i mbrujtur në llumin e shovinizmit të Fanarit, u bë renegat i Kishës dhe i popullit tonë dhe tregtar e rryshfetxhi i idealeve më të shenjta të saj, i fshehur nën maskën e Kryepeshkopit dhe të Episkopit, punoi gjithmonë në dëm të Kishës sonë, të cilën nuk e drejtoi kurrë sipas interesave të saj dhe të popullit shqiptar, por sipas interesave dhe sugjerimeve e diktateve të të huajve, duke e shikuar gjithnjë çdo çështje nën prizmin e rryshfetit....Nën cilësinë e Kryetarit të Sinodit dhe të Këshillit Miks dhe në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e këtij të fundit Andon Beça, Vangjel Gozhomani e Mihal Sherko dhe në prapaskenë me doktor Petrotën e delegatin Apostolik vendosi hedhjen e Kishës sonë në prehërin e unizmit, duke e prurë këtë çështje gjatë një mbledhjeje të Këshillit Miks dhe duke pritur rastin e volitshëm që të shpallte bashkimin definitiv dhe zyrtarisht me papën”. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl. 44-49.

⁶¹-*Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

⁶²-Paisi Vodica ka lindur më 1881 në Vodicë të Kolonjës. Në moshën 29-vjeçare u dorëzua prift dhe ka shërbyer në fshatin e tij të lindjes. Vite më vonë u zgjodh zëvendës episkop. Paisi Vodica ka përkrahur pa rezerva luftën nacional-çlirimtare deri në çlirimin e plotë të atdheut. Për meritat e tij patriotike gjatë luftës është nderuar me “Urdhërin e Flamurit” dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Pas çlirimit të vendit u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Paisi kishte qenë më parë i martuar dhe kishte mbetur i ve. Ai ishte i ati i Josif Pashkos, i cili në atë kohë mbante postin e Ministrisë të Ndërtimit. Më 18 prill të vitit 1948 në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë, arkimandrit

Shqipërisë⁶³. Në fjalën e tij Kryeepiskopi i sapofronëzuar tha: “*Sinodi i Shenjtë i Kishës tonë Ortodokse Autoqefale më ngarkoi barrën e rëndë që të jem në krye të kishës sonë. Kjo barrë si për moshën ashtu edhe për aftësitë e mia është shumë e rëndë, por, me ndihmën e gjithë besimtarëve, me ndihmën tuaj dhe të gjithë klerit dhe me përkrahjen e Pushtetit Popullor unë do të vë të gjitha forcat për të udhëhequr grigjën që mu besua. Në radhë të parë falënderoj Perëndinë e shumë fuqishmë për këtë ngritje që mu bë dhe me forcën dhe bekimin e Zotit tonë të Plotfuqishëm, Jisu Krishtit, do të plotësoj urdhërat e tij*”⁶⁴. Më 26 gusht 1949, sekretari i përgjithshëm Niko Çane në emër të Sinodit të Shenjtë njoftoi gjithë episkopatat dhe zëvendësitë mitropolitane për zgjedhjen e kryeepiskopit të ri. Më 29 gusht 1949, Kryeepiskop Paisi i dërgoi Patrikut të Moskës Aleksej një telegram, me anën e të cilit e njoftonte për emërimin dhe e garantonte se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do të ndiqte luftën kundër imperializmit. Më 19 shtator 1949 kryeepiskopi u dërgoi telegrame kishave bullgare, rumune, polake, çekoslllovale dhe gjeorgjiane, të cilat si pjesë e vendeve të bllokut sovjetik e njohën Paisi Vodican si kreun e ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Paisi e shpërfilli Patriarkanën Ekumenike, kishën greke dhe atë serbe, duke mos i njoftuar për zgjedhjen e tij në postin e kryetarit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në qarkoren që i dërgoi klerit ortodoks, Paisi theksonte se qëllimi i tij ishte të forconte lidhjet me kishat ortodokse të vendeve motra dhe veçanërisht me Patriarkanën e Moskës⁶⁵.

Me vendosjen e Paisit në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë regjimi komunist nisi procesin e konsolidimit të pushtetit. Kryesia e Kishës tashmë gjithë veprimtarinë e saj e përqendroi në funksion të interesave të pushtetit. Për të realizuar këtë Kryesia e Kishës duhej të spastronte personelin nga njerëzit e papërshtatshëm. Personelit iu kërkua të dorëzonin biografite në Kryesinë e Kishës. Biografite⁶⁶ u përdorën për të eliminuar rivalët në radhët e personelit të kishës. Në organikën e kishës u shtua një post,

Paisi Vodica u dorëzua Mitropolit i Korçës prej Kryeepiskopit Kristofor Kisi dhe një episkopi rus të quajtur Nestor, që kishte ardhur enkas për këtë punë. Ndërsa më 25 gusht 1949 Paisi u shpall Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 158.

⁶³-Dhori Qiriazi, *Krishtërimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 169.

⁶⁴-*Në katedralen orthodokse të Kryeqytetit u zhvillua mesha kryepiskopale e kryesuar nga Krye-Hirësia e tij, Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë Pasisi Vodica*, Bashkimi, 30 gusht 1949, faqe 3, 4.

⁶⁵-Sipas studiuesit Artan Hoxha pjesëmarrja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në bashkësinë e kishave ortodokse të botës kushtëzohej nga marrëdhëniet e shtetit shqiptar të asaj kohe. Për sa kohë që Greqia dhe Jugosllavia qenë vende armike me regjimin komunist shqiptar edhe marrëdhëniet me kishat e këtyre vendeve do të qenë armiqësore. Gjithashtu në krye të patriarkanës Ekumenike të Stambollit qëndronte një klerik proamerikan si Atenagora, prandaj edhe marrëdhëniet do të qenë jo të mira. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 126-127.

⁶⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951; Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014, faqe 7-8.

ai i nëpunësit të biografive, i cili u shpërndante dhe më pas administronte formularët e biografive të personelit.

Problem tjetër i rëndësishëm që edhe uniteti i përçarë i njerëzve që qenë zgjedhur në rangjet e larta kishtarë. Paisi vendosi të kryente spastrime në radhët e personelit kishtar. Të parët që u vunë në shënjestër qenë anëtarët e kryesisë së Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve, Theofan Popa, Vlash Nushi dhe Sotir Kanxheri, të cilët patën kundërshtuar hapur draftin e parë të Statutit. Mëria e teologëve të rinj ishte jo vetëm ndaj Paisit, por edhe ndaj Niko Çanes, që në atë kohë mbante postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kishës. Kundër Niko Çanes ishte edhe Dhimitër Kokoneshi. Në janar 1950 Kokoneshi i dërgoi një letër Mehmet Shehut me anën e së cilës e akuzonte rëndë Niko Çanen, si arkitektin e të gjitha konflikteve, që patën shpërthyer në Kryesinë e Kishës. Akuza më e fortë ishte se Niko Çane ishte njeriu i Kotokos në Kryesinë e Kishës. Ky fakt i vrau veshin Mehmet Shehut prandaj kërkoi një hetim të thellë mbi njeriun, që kishte kaq pushtet mbi Kryepiskopin Paisi Vodica. Kokoneshi, duke bashkëpunuar me Spiro Velin dhe Aristotel Straton kërkuan thirrjen e mbledhjes së Sinodit të Shenjtë, në të cilin do të merrej masa disiplinore ndaj kryesekretarit Niko Çane. Paisi Vodica vuri në dijeni kryeministrin Mehmet Shehu. Ky i fundit udhëzoi drejtorin e Komitetit Klerik, Gaqo Peristerin që ta shkarkonte Çanen nga detyra e sekretarit dhe ta emëronte diku në administratën shtetërore. Në këtë moment u fut në lojë Josif Pashko, i cili i quajti shpifje akuzat e Kokoneshit. Madje, Pashko theksoi se konflikti është kurdisur nga Irine Banushi, Theofan Popa, Dhimitër Beduli dhe Sotir Kanxheri⁶⁷. Nga ana tjetër Niko Çane u hodh në sulm, duke e akuzuar Kokoneshin si papist e reaksionar, që punonte kundër interesave të kishës në bashkëpunim me armiqtë Theofan Popa, Dhimitër Beduli, Sotir Kanxheri dhe Vlash Nushi.

KONGRESI I TRETË I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it (Fig.18) u çel në 7 shkurt të vitit 1950 në Tiranë. Në Kongres qenë të ftuar Kryetari i Komunitetit Mysliman Hafiz Musaj, Kryegjyshi Bektashian Ahmet Myftar Dede dhe nga Kisha Katolike Don. Zef Bicaj. Rendi i ditës së Kongresit ishte: 1-Aprovimi i vendimeve të Sinodit mbi disa ndryshime në udhëheqjen e kishës. 2-Shqyrtimi dhe aprovimi i projekt-statutit të ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë⁶⁸. Në ditët e punimeve të kongresit binte në sy mungesa e Kristofor Kisit dhe Irine Banushit, që qenë përjashtuar nga Sinodi. Fjalën përshëndetëse e mbajti Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Paisi, i cili pasi përshëndeti delegatët e kongresit nuk kurseu komplimentat për përfaqësuesin e

⁶⁷-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 180-181.

⁶⁸-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.17.

qeverisë dhe në veçanti për Enver Hoxhën⁶⁹. Për drejtimin e punimeve të Kongresit u zgjodh presidiumi, në përbërje të së cilit qenë: Kryehirësia e Tij, Paisi, Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Ikonom Aristotel Strato, Spiro Luarasi, Llazi Bozdo, Aleksandër Xhuvani dhe Zoto Boshari. Anëtarët e presidiumit pas thirrjes së emrave zunë vend në panelin kryesor në krah të Paisit. Ky i fundit propozoi sekretariatit teknik të kongresit për mbajtjen e procesverbaleve. Në sekretariat qenë Av. Vasil Xhaj, Koço Kostaqi dhe Kryedhjakon Sotir Kanxheri⁷⁰.

Në vijim foli përfaqësuesi i qeverisë Adil Çarçani, i cili përshëndeti punimet e kongresit. Ndër të tjera ai theksoi direktivat që duhej të ndiqte K.O.A.Sh-i në kuadrin e kursit të ri komunist që ishte vendosur në Shqipëri⁷¹.

Referatin kryesor të Kongresit e mbajti Kryeepiskopi Paisi Vodica, i cili foli rreth historikut të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe detyrat që i dalin asaj në kohën e sotme⁷². Pas referatit kryesor kongresi vazhdoi me diskutimet. I pari e mori

⁶⁹-Në *Tiranë u çel Kongresi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1.

⁷⁰-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.17.

⁷¹-Në fjalën e tij Adil Çarçani tha: “Më lejoni të përshëndes në emër të qeverisë Kongresin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe delegatët klerikë dhe laikë që marrin pjesë në këtë kongres. Misioni i Kishës është që t’i shërbejë popullit. Këtë mision kisha nuk u la ta kryente dhe nuk e kreu gjatë regjimeve të së kaluarës. Si çdo institucion tjetër ashtu edhe kisha përdorej si vegël për të gënjyer dhe për të shtypur masat duke çfrytëzuar ndjenjat e tyre fetare. Kisha ishte vegël e klikave reaksionare të brendshme, e qendrave fetare të huaja si kisha e Bizantit dhe Vatikanit, kështjella të fuqive imperialiste dhe kundërshtarë të vendosura të aspiratave të popullit për liri dhe demokraci. Ajo nuk ishte një faktor për bashkimin e popullit, por një instrument përçarjeje. Reaksioni u përpoq të përdori kishën për të thelluar akoma më shumë hendekun që kishte hapur në mes masave të popullit tonë të besimeve të ndryshme. Kisha sundohej nëpërmjet dinjitarëve të saj të lartë nga klikat feudal-borgjeze. Ata i diktonin kishës vullnetin e tyre dhe luftonin çdo pikëpamje të klerit...” Në përfundim të fjalës së tij shoku Adil Çarçani tha: “Në demokracinë tonë popullore liria e kishës, liria e ndërgjegjes dhe e besimit është e plotë. Në demokracinë tonë polpullore janë vendosur marrëdhënie të drejta në mes të Shtetit dhe Kishës, zbatohet drejt parimi i drejtë i ndarjes së kishës nga shteti. Bazat e këtyre raporteve janë hedhur në ligjin themelor të shtetit, në Statutin e Republikës Popullore dhe janë përcaktuar me hollësi në ligjin e ri mbi komunitetet fetare. Shteti ynë nuk ndërhyr në punët e brendshme të kishës dhe kisha nuk duhet të përzihet në aktivitetin politik të shtetit. Ky është koncepti i ndarjes së kishës nga shteti dhe kështu duhet të zbatohet në marrëdhëniet në mes tyre...” *Përshëndetja e përfaqësuesit të Qeverisë Shokut Adil Çarçani*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 291, viti 1950, fl. 1.

⁷²-Ndër të tjera Kryeepiskopi Paisi Vodica tha: “Asnjëherë Kisha jonë nuk ka pasur mundësinë të praktikojë parimet e saj të larta mbi dashurinë, vëllazërimin dhe paqen midis njerëzve se sa në shoqërinë e sotme. Të drejtat e kishës janë të garantuara dhe të sanksionuara me anën e Statutit të Republikës sonë Popullore. Ligji i ri mbi komunitetet fetare i përcakton në mënyrë të përsosur të drejtat dhe detyrat e kishës dhe të funksionarëve të saj. Dhe ky statut dhe ky ligj janë gjëra të shenjta për ne. Duhet pasur gjithmonë parasysh dhe të mos harrohet në asnjë çast se detyra e kishës sonë është që të jetë besnike e Republikës sonë Popullore, besnike e popullit dhe aspiratave të tij, besnike e atdheut tonë të dashur dhe flamurtare e predikatore e unitetit popullor, luftëtare e mbrojtjes së kufinjve të shenjta dhe të lirisë së independencës dhe integritetit tokësor të atdheut tonë kundër tentativave grabitqare. Dhe kur themi kisha nënkuptojmë gjithë funksionarët dhe nëpunësit e saj, klerikë dhe laikë, gjithë besnikët ortodoksë, që nga më i madhi e gjer tek më i vogli. S’ka kishë të lirë pa atdhe të lirë dhe popull të lirë. Gjithashtu kisha jonë duhet të jetë besnike

fjalën zëvendësi i përgjithshëm i Mitropolisë së Korçës, Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi. Në vijim u lexua telegrami që kishte dërguar Patriku i Moskës dhe i gjithë Ruisë Aleksej. Ky i fundit shprehte keqardhjen se për arsye kohe nuk kishte mundur të dërgonte një delegacion kishtar në kongres. Në seancën e dytë të kongresit diskutuan: delegati i Tiranës, Jorgji Pano, delegati i Korçës av. Kristo Pilika, delegati i Vlorës, Thimi Opingari, delegati i Durrësit, Stavrofor atë Erazmi Jorgo⁷³, (Fig.19) delegati i Pogradecit atë Kristo Bitro, delegati i Gjirokastrës av. Vasil Xhaj, delegati i Beratit atë Kostandin Arbëri, delegati i Shkodrës atë Llazar Popoviç, delegati i Fierit Stavrofor atë Polizoi Ikonomi⁷⁴ (Fig.20) etj⁷⁵.

kampit të madh anti-imperialist dhe demokratik, e kampit unik të socializmit të udhëhequr shkëlqimisht nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe i madhi Stalin kundër çdo tentative që ndërmer imperializmi skllavëronjës për të minuar paqen ndërkombëtare dhe për të hedhur botën në një kasaphanë dhe katastrofë të re. Pikërisht dhe këtu e ka vendin dhe kisha jonë, në gjirin e kampit të madh dhe unik të paqes, ku bëjnë pjesë kishat ortodokse përparimtare të botës me në krye kishën e madhe ortodokse ruse, e cila qëndron në ballë të kampit kishtar progresiv për një dashuri, vëllazërim dhe paqe të vërtetë. E kemi për nder të madh që jemi lidhur me Kishën e Madhe Ortodokse Ruse, e cila interpreton dhe praktikon drejt parimet e larta ungjillore mbi dashurinë, vëllazërimin dhe paqen dhe që udhëhiqet nga prelatë të lartë siç është shenjtëria e tij patriku i Moskës dhe i gjithë Ruisë Aleksej. Vizitat që kemi bërë dy herë në Bashkimin Sovjetik na kanë dhënë shumë dritë në këtë drejtim dhe kanë bërë që lidhjet tona të jenë të pavdekshme. Gjithashtu e kemi për nder që kisha jonë ka lidhje të ngushta bashkëpunimi dhe me kishat ortodokse të demokracive motra që punojnë në të njejtën rrugë...”. Ndër të tjera Paisi tha: “Kisha duhet të mobilizohet dhe të japë kontributin e saj maksimal në zgjidhjen e problemeve aktuale të popullit, në respektimin dhe zbatimin e urdhëresave dhe të ligjeve, në realizimin e planit, në përmbushjen e detyrimeve etj. Priftërinjtë në qytete dhe sidomos në fshatra të lozin një rol të rëndësishëm dhe të bëhen vetë shembull në plotësimin e planeve të shtetit dhe në shlyerjen e detyrimeve karshi shtetit duke udhëzuar në këtë drejtim besimtarët. Ata duhet të jenë patriotë të kulluar...”. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 4-12.

⁷³-Erazmi Jorgo (1900-1989) është dorëzuar në dhiakon më 15 mars 1924. Pas një muaji më 16 mars të vitit 1924 u dorëzua në gradën priftërore, në Kishën e Ungjillëzimit të Tiranës nga Imzot Fan Noli. At Erazmi ishte prifti i parë i dorëzuar nga Fan Noli. Pas ceremonisë së dorëzimit, Imzot Noli i pati thënë: “Paske zë të hyjshëm bir.” At Erazmi ka shërbyer prej vitit 1927 në Kishën e Shën Gjergjit në Durrës, e cila për disa vite ishte njëherësh Seli e Mitropolisë së Shenjtë të Durrësit dhe Tiranës. Lidhjen shpirtërore me Imzot Nolin At Erazmi e mbajti gjatë gjithë jetës.

⁷⁴-Polizoi Ikonomi (1894-1967) ka lindur në fshatin Sop të rrethit të Fierit më 11 mars të vitit 1894. Është dorëzuar prift në Fier më 31 janar 1924 nga ish Mitropolit i Beratit, Kristofor Kisi. Më 23 shkurt të vitit 1928, ai mori gradën Ikonom prej Mitropolitit të Beratit, Kristofor Kisit. Më 16 qershor të vitit 1929 Ikonom Polizoi mori pjesë si delegat në Kongresin e Dytë të KOASH-it, që u zhvillua në qytetin e Korçës. Më 31 dhjetor të vitit 1929 Polizoi Ikonomi u bë Stavrofor nga Episkopi i Beratit Imzot, Agathangjel Çamçe. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, Stavrofor Polizoi Ikonomi u emërua “Zëvendës i Mitropolitit i qytetit të Fierit” nga Imzot Visarion Xhuvani. Stavrofor Polizoi Ikonomi shërbeu 43 vjet në kishën e Shën Gjergjit të Fierit. Në shkurt 1950 Stavrofor Polizoi Ikonomi ka qenë delegat i Fierit në Kongresin III kishtar të KOASH-it që zhvilloi punimet në Tiranë. Më 1 dhjetor 1966 Stavrofor Polizoi u emërua sërish në postin e zëvendës Mitropolitit. Këtë herë emërimi i tij u bë nga Episkopi Beratit Spiridhoni. Më 21 janar të vitit 1967, ai bëri shërbesën e fundit në kishën e Shën Gjergjit të Fierit, ndërsa më 5 shkurt të po këtij viti, një ditë para fillimit të uraganit ateist, vdiq në moshën 73 vjeçare. Nuri Plaku, *At Polizoi Ikonomi një emër i nderuar në kujtesën e ortodoksëve myzeqarë*, Fier 2019.

Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it u mbajt 5-10 shkurt të vitit 1950 në Tiranë. Në përfundim të punimeve të Kongresit të tretë të K.O.A.Sh-it u miratua statuti dhe rregullorja e re e përshtatur me kushtet politike dhe sociale të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Më 16 shkurt 1950 statuti iu dërgua Seksionit Klerik pranë Kryesisë së Këshillit të Ministrave me qëllim që ky t'ia përcillte Presidiumit të Kuvendit Popullor për shqyrtim dhe aprovim⁷⁶.

Statuti është aprovuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor⁷⁷ me Dekretin Nr. 1065 datë 4 Maj 1950. Rregullorja e Administrimit të Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, u përpilua sipas dispozitave të Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të ligjit mbi komunitetet fetare. Në hartimin e Rregullores mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u caktua një komision i përbërë nga:

Kryetar -Kryepiskopi Pais Vodica. d.v.

Anëtar -Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi. d.v.

Anëtar -Ikonom Stavrofor atë Aristotel Strato d.v.

Anëtar -Ikonom Stavrofor atë Spiro Veli d.v.

Anëtar -Spiro Luarasi d.v.

Anëtar -Jorgji Pano d.v.

Anëtar - Kristo Cevo d.v.

Sekretari Përgjithshëm -Niko Çane d.v

Rregullorja mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë⁷⁸ u aprovua me anën e Vendimit Nr. 1085, datë 28.12.1950, të Këshillit të Ministarve të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KRIJIMI I SINODIT TË SHENJTË

Siç e kemi theksuar edhe më sipër më 25 gusht 1949 Pasi Vodica u shpall Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Që të formonte Sinodin e Shenjtë të Kishës Autoqefale të Shqipërisë duheshin kandidatë të mundshëm potencialë që të plotësonin kriteret nga ana kanonike. Çështja e plotësimit të Sinodit të Shenjtë qe hapur që në Kongresin III të K.O.A.Sh-it, kur në sesionin e paradites së datës 8 shkurt

⁷⁵-Në Tiranë u çel Kongresi i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1, 2; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.1-2.

⁷⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.29.

⁷⁷-Statuti i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 1950, në "Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Shqipërisë", Nr. 38, 21 qershor 1950, faqe 2-19; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.31.

⁷⁸-Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë, Mihal Duri, Tiranë, 1955; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 691, viti 1955, fl. 1-22.

1950 delegati Siku Gjoka propozoi dorëzimin e arkimandritit Dhimitër Kokoneshi në gradën episkopale. Propozimi u prit me duartrokitje të zjarrta nga ana e delegatëve, por Kokoneshi me modesti e refuzoi këtë propozim me arsyen se nuk i plotësonte kushtet për tu bërë episkop. Delegati i Gjirokastrës Niko Çane e miratoi refuzimin e Kokoneshit, ndërsa teologu Dhimitër Beduli theksoi faktin se në historinë kishtare ka pasur raste, që klerikë të ndryshëm të ngrihen në gradën episkopale me imponimin e popullit, siç qe rasti i Ambrozit të Milanos⁷⁹.

Më 7 mars 1950, zëvendësepiskopi i Himarës, Jani Kutulla propozoi në emër të priftërinjve të zonës së Bregut kandidaturën e Foto Dunit. Më 17 tetor 1950 Sinodi i Shenjtë⁸⁰ i mbledhur nën kryesinë e Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Paisit, me anëtarët; arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Zëvendës i përgjithshëm e Episkopatës së Korçës dhe Ikonom Aristotel Straton, Zëvendës i përgjithshëm i Episkopatës së Gjirokastrës dhe me sekretar Z. Niko Çane vendoi unanimitisht atë Spiro Velin⁸¹ si titullar të Episkopatës së Beratit me cilësinë e zëvendësit episkopal⁸². Gjithashtu atë Spiro Velit dhe atë Aristotel Stratos iu dha grada e nderit Ikonom-Stavrofor.

⁷⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 290, viti 1950; fl. 28-29; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl. 3.

⁸⁰-Me këtë përbërje Sinodi i Shenjtë ishte antikanonik. Sipas kanoneve kishtare vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj.

⁸¹-Spiro Veli (1914-1995) ka lindur më 1914, në Erind të Gjirokastrës. Që në moshën 18-vjeçare ka studiuar në seminarin Ortodoks "Apostol Pavli" në Tiranë, që drejtohej prej Vasarion Xhuvanit. Pas mbarimit të seminarit më 1936, banoi në qytetin e Durrësit, duke punuar mësues i fesë, njëkohësisht kryente edhe detyrën e psaltit në kishën e Shën Spioridhonit. Më 1 janar të vitit 1945 dorëzohet dhiak dhe më 3 janar të po atij viti, hirotoniset në gradën priftërore. Atë Spiro Veli shërbente në qytetin e Durrësit së bashku me Atë Erazmi Jorgon, duke lënë mbresat më të mira për urtësimë, ndershmërinë dhe profesionalizmin e tij. Në vitin 1948 së bashku me arqimandrit Dhimitër Kokoneshin morri pjesë në delegacion kishtar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, në Bullgari e Rumani. Në vitin 1950 emërohet zëvendësi i përgjithshëm i Episkopatës së Beratit. Duke parë punën e tij të mirë organizative, më 1953 emërohet Zëvendës i përgjithshëm në Mitropolinë e Elbasanit. Gjatë viteve të diktaturës punoi në punë të ndryshme shekulare si shitës kinkalerie, shitës tullash apo roje. Në vitin 1991, rihapja e kishës së Shën Marisë në Elbasan e gëzoi pa masë. Ndonëse në moshën 81-vjeçare, Atë Spiro Veli punoi me përkushtim dhe devodshmëri deri sa vdiq më 23 prill 1995, në ditën e Pashkës së Madhe. At Stavri Çipi, *At Spiro Veli, shembull i një kleriku të devotshëm*, Ngjallja, qershor 2005, faqe 9; Andrea Lluknai, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 263-264; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 162-163.

⁸²-Atë Spiro Veli do të qe me cilësinë e zëvendësit episkopal të Përgjithshëm me të drejtat që i jepte eni 85 i Statutit: "Në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqeze mund të zgjidhet në të njëjtën mënyrë një klerik i dalluar me titull: "Zëvendës Episkopal i Përgjithshëm", i cili porsa kohë që administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe të njëjtën të drejtë anëtarësie në Sinodh, me përjashtim të atyre kompetencave që i përkasin ekskluzivisht gradës episkopate. Edhe ky jep të njëjtin betim përpara Sinodhit të Shenjtë". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 13.

Pas shumë përpjekjesh dhe negociatash u hartua lista me kandidatët për episkopë: Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Mitropolit i Gjirokastrës, Qirjako Efthimi (Naslazi), Mitropolit i Beratit, Foto Duni, Mitropolit i Korçës dhe Imzot Sofron Borova⁸³ ndihmës episkop. Miratimi i qeverisë për hirotonisjen e klerikëve në gradën episkopale u bë më 8 nëntor 1952. Problem i madh ishte se kush do të dorëzonte kandidatët për episkopë. Qe menduar se episkopët e rinj do të dorëzonte Paisi dhe Irineu, por ky i fundit nuk pranoi në asnjë mënyrë të bënte veprime antikanonike. Sipas kanoneve kishtarë zgjedhja e episkopëve mund të bëhej nga një sinod i përbërë të paktën nga tre episkopë.

Në lidhje me dorëzimin e episkopëve të rinj Irine Banushi ka deklaruar: “Rruga e daljes ishte që më parë t’ja parashtronim udhëheqjes dhe nëse kjo dëshironte, Paisi dhe Irineu të shkonin në Moskë dhe aty të parashtronin situatën dhe të legalizohej Irineu (sepse ishte shkarkuar nga grada episkopale). Në vijim të mblidhej sinodi kanonik i përbërë nga Paisi, Kristofori dhe Irineu, ku Paisi të ishte kryepiskop, ndërsa Kristofori dhe Irineu episkopë të ndonjë dioqeze. Vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj. Pasi të dorëzoheshin episkopët, Kristofori dhe Irineu do të jepnin dhorëheqjen. Irineu do të parashtronte Sinodit dorëheqjen për shkak të sëmundjes, ndërsa Kristofori për shkak pleqërie. Kështu do të ishin brenda kanoneve dhe rregullave që përcakton neni 22 i statutit të vitit 1929, i cili thotë: “*Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t’i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos....*”⁸⁴.

Kreu i Komitetit Klerik, Gaqo Peristeri dhe Niko Çane shkuan në manastirin e Shën Vlashit për të bindur Irineun, që të merrte pjesë në dorëzimin e episkopëve. Irine Banushi nuk pranoi. Ai kundërshtoi hapur shkeljet dogmatike dhe kanonike që po bëheshin në atë kohë nga njerëz të pashkolluar, të cilët kishin zënë poste drejtuese në kishë vetëm se kishin luftuar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Irineu nuk pranoi të merrte pjesë në dorëzimin episkopëve të rinj, të cilët më parë kishin qenë priftërinj të martuar. Pasi kishin mbetur të ve ata kërkonin të ngjishnin shkallët më të larta të hierarkisë kishtarë duke shkelur kanonet e shenjta. Ky ishte shkaku që Irine Banushi u burgos përsëri në vitin 1952.

⁸³-Sofron Borova ka lindur në Borovë të Kolonjës më 1881. Në moshë të re shkoi në Athos ku u qeth murg. Pasi u kthye në atdhe ka shërbyer si klerik në rrethin e Korçës. Sofron Borova shihej me sy të mirë nga regjimi për shkakun se gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare nga familja e tij qenë gjashtë dëshmorë. Kriteri matës që përcaktonte qëndrimin e mirë politik në atë kohë ishte angazhimi personal ose familjar në lëvizjen nacional-çlirimtare. Në tetor 1952 u dorëzua në gradën episkopale, detyrë të cilën e kreu deri më 3 gusht 1963 kur edhe vdiq. Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 40-41.

⁸⁴-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000, faqe 39.

Në këto kushte alternativa e vetme ishte Kristofor Kisi. Në fund të gushtit 1952, Kisi pranoi të merrte pjesë bashkë me Vodicien në dorëzimin e episkopëve, duke kërkuar si shkëmbim rehabilitimin e tij. Më 14 shtator 1952 në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë u dorëzua episkop i Gjirokastrës Dhimitër Kokoneshi, i cili mori emrin Damiano⁸⁵. Dorëzimi u bë nga episkopët Paisi dhe Kristofor. Më 21 shtator 1952 Sofron Borova u dorëzua episkop ndihmës prej episkopëve Paisi, Kristofor dhe Damiano. Më 28 shtator 1952 në katedralen Burimi Jetëdhënës në Korçë u hirotonis Foto Duni, i cili mori emrin Filothe, ndërsa më 12 tetor 1952 në katedralen e Shën Dhimitrit në Berat u hirotonis Qirjako Naslazi, i cili mori emrin Qirill⁸⁶. Ky ishte Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. (Fig.21) (Fig.22)

Më 17 qershor 1958 Kristofor Kisi vdiq në rrethana të dyshimta në kishën e Shën Prokopit. Varrimi i Kristofor Kisit u bë më datën 18 qershor 1958. Arkivoli që mbante trupin e tij u vendos në mesin e kishës katedrale të “Ungjillëzimit” në Tiranë. Ceremonia e përmortshme u kryesua nga Fortlumturia e tij, Paisi, me pjesëmarrjen e Episkopit Ndhimës Sofronit, Arkimandrit Dhanil Çulit, Stavrofor Thoma Popës, Ikonom Marko Papajanit, Saqellar Petro Doçit, Kryedhjakonit Sotir Kanxheri etj. Në prani të të afërmve dhe besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën, foli Sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane, i cili theksoi virtytet e të ndjerit⁸⁷.

Episkopi ndihmës, Sofron Borova vdiq në vitin 1963 në moshën 82-vjeçare dhe vendin e Episkopit të Apolonisë e zuri Dhanil Çuli. Me vdekjen e Mitropolitit të Korçës, Filotheut, vendin e tij e zuri Qirilli. Në vendin e Qirillit si Mitropolit i Beratit më 27 janar të vitit 1965 u dorëzua Spiridhon Papa⁸⁸. Kryepiskop Paisi në vitet e fundit të jetës së tij ka qenë i sëmurë dhe administrimi i K.O.A.Sh-it bëhej prej episkopit ndihmës Dhanil Çulit. Paisi Vodica ndërroi jetë më 4 mars të vitit 1966 pas një hemoragjie cerebrale. Kryesia e Kishës me anën e një njoftimi të posaçëm⁸⁹, i cili mban datën 4 mars 1966 njoftonte vdekjen e Fortlumturisë së Tij, Paisit. Njoftimi është nënshkruar nga Episkop Damjan Kokoneshi, Episkop Spiridhon Papa, Episkop Dhanil Çuli, Niko Çane, Jorgji Pano, Ikonom Andrea Prifti, Ikonom Grigor Zografi etj. Ceremonia e varrimit u bë në 5 mars 1966 në Kishën Katedrale të “Ungjillëzimit” në Tiranë⁹⁰.

⁸⁵-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 31.

⁸⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 476, viti 1950, fl. 44-54.

⁸⁷-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38.

⁸⁸-Spiro Papa ka lindur më 1885 në Sinjë të Beratit. Në vitin 1934 u dorëzua prift. Për 33 vjet ka shërbyer si famullitar i fshatit Paftal të Beratit. Pas disa viteve mbeti i ve dhe më 1965 u hirotonis Mitropolit i Beratit. Familja e tij ka qenë e lidhur me regjimin. Spiro Papa ka qenë babai i kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Beratit. Imzot Spiro Papa ka vdekur në vitin 1970. Ikonom Vangjel Xoxe, Ilia Zaka, *Spiro Theodor Papa*, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 9-10; *Ata që punuan për kishën tonë. Imzot Spiro Papa*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 11.

⁸⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966, fl.5.

⁹⁰-Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 77.

Sinodi i Shenjtë i K.O.A.Sh-it në mbledhjen e datës 7 mars 1966 zgjodhi unanimitisht në postin vakant të kryeepiskopit, Episkopin e Gjirokastrës, Hirësinë e Tij, Damianin. Me anën e Qarkores me numër 24/11, datë 14 mars 1966 njoftoheshin episkopatat e hirëshme dhe zëvendësitë mitropolitane në lidhje me vendimin e Sinodit të Shenjtë të datës 7 mars 1966, ku u zgjodh me vota unanime në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Hirësia e Tij, Damiani. (Fig.23) Gjithashtu Fortlumturia e Tij, Damiani do të mbante përkohësisht drejtimin e Mitropolisë së Gjirokastrës si *Ad interim*. Titullarët e Episkopatave të Hirëshme u porositën që gjatë celebrimit të shërbesave fetare të përmendnin emrin e Kryeepiskopit të sapofronëzuar. Qarkorja mbante firmën e Episkopit Ndhimës Dhanilit⁹¹. Pas zhvillimeve të mësipërme sinodi i ri përbëhej nga Fortlumturia e Tij, Damjani⁹², në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Qirilli, Mitropolit i Korçës, Imzot Spiridhon Papa, Mitropolit i Beratit dhe Episkopi i Apolonisë, Dhanil Çuli si ndihmës i Kryeepiskopit.

FUNDI I KRYEPESHKOPIT DAMJAN

Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në një mbledhje të posaçme të datës 22 shkurt të vitit 1967 vendosi që klerikët të hiqnin rasant. Mbledhja kryesohej nga Kryeepiskopi Damiano, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, Episkopin e Beratit Spiridhonin dhe Episkopin ndihmës Dhanilin si dhe Sekretarin e Sinodit të Shenjtë Z. Niko Çane. Episkopi i Korçës, Kirili për arsye shëndetësore nuk ishte i pranishëm në mbledhjen e Sinodit, por dha pëlqimin me shkrim, me anën e shkresës me numër protokolli 13, datë 24 mars 1967. Sipas Urdhërësës së Sinodit të Shenjtë klerikët duhet të hiqnin rasant dhe të dilnin në publik me veshje civile: “Me të marrë letrën tonë, brenda 24 orëve të visheni me veshje civile, në qoftë se këtë nuk e keni bërë deri më sot, duke na njoftuar se e zbatuat urdhërin tonë përkatës, sepse ndryshe nuk mund tu dërgojmë rrogën e muajit mars”⁹³.

⁹¹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1334, Viti 1966, fl.1.

⁹²-Dhimitër Kokoneshi ka lindur më 26 tetor të vitit 1886 në fshatin Llëngë të Pogradecit. Në vitin 1925 Dhimitër Kokoneshi ka përfunduar Seminarin në Janinë të Greqisë. Në vitin 1927 Dhimitër Kokoneshi u dorëzua prift nga Kryeepiskop Visarion Xhuvani. Atë Dhimitër Kokoneshin e emëruan në kishën e Shën Marenës në manastirin e Llëngës. Më 31 korrik të vitit 1927 atë Dhimitër Kokoneshi ka celebruar meshën e parë në kishën e Shën Marenës. Me fjetjen e bashkëshortes në vitin 1939 atë Dhimitër Kokoneshi mori ofiqin e arkimandritit. Ndërkohë mori emrin Damjan. Në tetor të vitit 1947 arkimandrit Damjan Kokoneshi u dorëzua në gradën episkopale prej Hirësisë së Tij, Paisit dhe Hirësisë së Tij, Kristoforit dhe u emërua Mitropolit i Gjirokastrës. Më 7 mars 1966 Damjan Kokoneshi u fronëzua Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Dhimitër Kokoneshi vdiq më 18 tetor të vitit 1973 kur ishte në moshën 87-vjeçare. Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2; Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78.

⁹³-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1367, Viti 1967, fl.4.

Atë Jorgji Zaro nga Bularati i Dropullit në shënimet e tij ka shkruar: “*Na mblodhi, në fund dimri, mitropoliti i Gjirokastrës, të gjithë klerikët e Mitropolisë. Na porositi me ton urdhërues që deri në fillim të marsit të kemi rruajtur mjekrat, të kemi zhveshur rasot dhe të kemi dorëzuar në organizatat e rinisë komuniste kishat tona. Ishte ftohtë dhe ngricë. Dhe atmosfera u ngri e gjitha. Heshtja ishte e tmerrshme. Guxuan dhe reaguan vetëm klerikët e ardhur nga zona e Himarës*”⁹⁴.

Më 18 prill 1967, Zija Beqiri, kreu i ri i Komitetit Klerik zhvilloi një takim me krerët e bashësive fetare. Në takim Kryeepiskopi Damjan Kokoneshi shprehu shqetësimin që fondi klerik të mos prekej, sepse kishte të bënte me pensionet e klerikëve që nuk qenë në moshë pune. Ndër të tjera Kokoneshi theksoi se llogaritë e kishave qenë krijuar me të ardhurat e vetë klerit, prandaj nuk duhet të prekeshin. Përfundimisht në takim u vendos që komunitetet fetare do të bashkonin llogaritë bankare në një llogari të vetme. Në qershor 1976 me urdhër të Ministrisë së Financave, Banka e Shtetit e krijoi këtë llogari⁹⁵. Nuk vonoi shumë dhe Kryesia e Kishës nxori njoftimin drejtuar arkave të kursimeve mbi faljen e obligacioneve shtetit⁹⁶.

Klerikët duhet të paraqiteshin nëpër zboret ushtarake. Në telegramin që i dërgonte sekretari i Kryesisë së Kishës Niko Çane, Zëvendësisë episkopale të Himarës i shkruante: Ne demarshuam, por ligji përkatës nuk i përjashton klerikët nga deyrimi ushtarak. Interesohuni pranë Degës ushtarake aty”⁹⁷. Në vitin 1965 Këshilli i Ministrave me vendim të posaçëm hoqi përkatësinë fetare nga dokumentet e identifikimit⁹⁸. Klerikët ortodoksë filluan të përbuzen dhe të tallen nga rinia⁹⁹. Kjo bëhej që ata të mos guxonin të dilnin rrugëve të qytetit. Po pati edhe klerikë trima¹⁰⁰ nga ata që patën luftuar dhe nuk u dridhej qerpiku.

Fortlumturia e Tij, Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Damjan Kokoneshi e përballoi me urtësi mbyllën e kishave. Ishte ai që urdhëroi klerikët që qenë nën varësinë e tij për të qethur mjekrat, për të hequr veshtjet klerikale dhe për të mbyllur kishat. Atë Marko Papajani në shënimet e tij ka shkruar: “*Më datën 5 mars 1967, ditë e dielë në kishë vajta pa mjekër, pa veshje dhe pa kamillaf në kokë. Më datën 20 mars 1967 në mbrëmje kisha e Ungjillëzimit u mbyll duke mos u shërbyer besimtarëve. Më datën 7 prill të vitit 1967 me urdhër të Kryeepiskop Damjanit kisha e Ungjillëzimit u hap përsëri deri në mbrëmjen e 31 majit 1967, kur u mbyll përfundimisht*”¹⁰¹.

⁹⁴-Orfea Beci, *Orthodhoksi e çliruar, sepse u ngjall*, Kërkim, Nr.9, Tiranë, 2012, faqe 81-82.

⁹⁵-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 277.

⁹⁶-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1382, viti 1967, fl.1-2.

⁹⁷-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1237, viti 1964, fl.1-2.

⁹⁸-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 241.

⁹⁹-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1161, fl.1-2; Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

¹⁰⁰-Damjan Kokoneshi po kalonte pranë kafe “Flora” dhe disa të rinj që qenë ulur në bordurën e rrugës filluan ta tallin, duke thënë “ta lashë”. Kokoneshi nxorri koburen nga brezi dhe e kërcënoi njerin prej tyre. Lajmi u përhap anembanë qytetit dhe që nga ajo kohë nuk guxonte më njeri të tallej me të duke i thënë “ta lashë”.

¹⁰¹-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 44-46.

Sekuestrimi i librave fetarë dhe sendeve të shenjta shkaktoi një brengë të madhe në shpirtin e Fortlumturisë së Tij, Kryeepiskop Damjan Kokoneshit. Nga dhimbja që ndjente ai u mbyll në vetvete dhe u largua nga shoqëria. Si klerik që ishte, njerëzit filluan ta shohin me sy tjetër. Të afërmit tregojnë se gjatë këtyre viteve Damjan Kokoneshi lutej vazhdimisht me shpresë se një ditë do të vinte përsëri liria e fesë. Vitet e fundit të jetës Damjan Kokoneshi i kaloi në shtëpinë e së bijës Lirisë, e cila e donte dhe e respektonte. Lirisë ia la amanet që kur të vdiste ta varrosnin në manastirin e Llëngës, prapa hierores së kishës, aty ku zakonisht varrosen hierarkët e lartë të kishës. Para se të ndërronte jetë më 18 tetor të vitit 1973 u la amanet fëmijëve, që kryqin dhe veshjet klerikale t'ia vinin në varr, sepse pranë tyre do ta ndjente veten gjithnjë në shërbim të Perëndisë¹⁰².

¹⁰²-Stavri Kazanxhi, *Bariu i grigjës rrëmëne*, Fratia, prill 1999, faqe 3.

BURIME ARKIVORE

- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951, fl. 34-36.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja nr. 1470, viti 1951, fl.3-4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 42.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 43.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947, fl.2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.11.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.32.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja 1333, viti 1966.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 218, viti 1948, fl. 2-4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 32.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 23-24.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 140, Dosja Nr. 60, fleta 51.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi Nr. 536, Dosja Nr. 232, fl.115.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 5.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 8.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl. 44-49.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.17.

- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 291, viti 1950, fl. 1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 4-12.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.1-2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.29.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.31.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 691, viti 1955, fl. 1-22.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 290, viti 1950; fl. 28-29.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl. 3.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 13.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 476, viti 1950, fl. 44-54.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966, fl.5.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1334, Viti 1966, fl.1.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1367, Viti 1967, fl.4.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1382, viti 1967, fl.1-2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1237, viti 1964, fl.1-2.
- Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1161, fl.1-2.
- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.
- Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Mihal Duri, Tiranë, 1955.
- Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929.
- Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, në “Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Nr. 38, 21 qershor 1950.

BIBLIOGRAFI

- Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
- Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019.
- Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Andrea Llukani, *Mitropolia e Korçës*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2020.
- Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014.
- Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
- Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017.
- Arumunët e Shqipërisë, *Histori dhe dokumente për figura të shquara historike*, botim i Shoqatës Arumunët e Shqipërisë.
- At Dhimitër Kokoneshi, *figurë e shquar e fesë dhe kombit*, Mokra, fletëpalosje e botuar me sponsorizimin e Znj. Zografa Kokthit, mbesës së atë Dhimitër Kokoneshit.
- Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014.
- Eugenia Drakopoulou, *Icons from the Orthodox Communities of Albania*, Thessaloniki, 2006.
- Ευγενια Δρακοπούλου, *Εικονες απο τις ορθοδοξες κοινοτητες της Αλβανιας*, Θεσσαλονίκη, 2006.
- Dorian Koçi, Andrea Llukani, *Pavijoni i ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar*, (dorëshkrim i pabotuar), Tiranë 2018.
- Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Nereida, Tiranë 2007.
- Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992. -Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006.
- Dhori Qiriazhi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000.
- Jetë shenjtorësh, Nr. 6*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1996.
- Gjergji Gusho, *Mbi përhapjen e krishtëritimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit*, Pogradec 2000.
- Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike, Neraida*, Tiranë 2001.
- Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006.
- Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015.
- Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004.

- Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000.
- Melsi Labi, Dorian Koçi, *Udhërrëfyes i Muzeut Historik Kombëtar*, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë 2014.
- Melsi Labi, *Guidebook of National Historical Museum of Albania*, Tirana 2016.
- Nuri Plaku, *At Polizoi Ikonomi një emër i nderuar në kujtesën e ortodoksëve myzeqarë*, Fier 2019.
- Trashëgimia Kulturore akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2003.
- Theofan Popa, *Mbishkrime të Kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998.
- Ylli Drishti, *Kostandin Shpataraku, piktori i artit mesjetar shqiptar*, Tiranë 1992.
- Ylli Drishti, *Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri*, Davinci, Tiranë, 2003.
- Ylli Drishti, *The Byzantine and Post-Byzantine Icons in Albania*, Davinci, Tirana, 2003.

ARTIKUJ NË REVISTA SHKENCORE DHE GAZETA

- Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93.
- At Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e fesë dhe kombit*, Mokra, shkurt- mars 2001, faqe 4-5.
- Ata që punuan për kishën tonë. Imzot Spiro Papa*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 11.
- Dorian Koçi, *Thesare kulturore nga Voskopoja në Muzeun Historik Kombëtar*, botuar në: *Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, faqe 404.
- Ikonom Vangjel Xoxe, Ilia Zaka, *Spiro Theodhor Papa*, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 9-10.
- Fiqiri Shahinllari, *Armunët janë bërë pjesë e pandarë e popullit shqiptar*, Republika, 15 nëntor 2006, faqe 11.
- Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.
- Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.
- Llazi Tona, *Në labirintet e monumenteve kulturore historike të përbotshme*, Mokra, prill 2009, faqe 7.
- Milco Georgievski, *St. Marina of Antioch and her representations on tëo icons from the Icon Gallery in Ohrid*, Academia.edu.

- Milco Georgievski, *Icon Galery-Ohrid*, Ohrid 1999, page 96; *Ohrid Macedonia, City Guide*, Publisher: Municipality of Ohrid, page 28-30.
- Moikom Zeqo, *Një ikonë e re e panjohur e Konstandin Shpatarakut*, Ekskluzive, nr. 20, dhjetor 2001, faqe 111-112.
- Në katedralen orthodhokse të Kryeqytetit u zhvillua mesha kryepiskopale e kryesuar nga Krye-Hirësia e tij, Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë Pasisi Vodica*, Bashkimi, 30 gusht 1949, faqe 3, 4.
- Në Tiranë u çel Kongresi i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1.
- Orfea Beci, *Orthodhoksi e çliruar, sepse u ngjall*, Kërkim, Nr.9, Tiranë, 2012, faqe 81-82.
- Panagjiristi, *Një kremtim madhështor në manastirin e Shën Marenës*, Kisha Kombëtare - Tiranë – 17.08.1930.
- Pandi Sotir Konomi, *At Dhimitër Kokoneshi-figurë e shquar e fesë dhe e kombit*, Kushtrim Brezash.
- Përshëndetja e përfaqësonjësit të Qeverisë Shokut Adil Çarçani*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1.
- Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2.
- Stavri Kazanxhi, *Bariu i grigjës rrëmëne*, Fratia, prill 1999, faqe 3.
- Tahir Gaxhenji, *Vllahët, bij të kombit të zhdukur Romen*, Sot, 27 dhjetor 2003, faqe 12-13.
- Tedi Blushi, *Shifrat zyrtare të minoriteteve*, Standard, 11 nëntor 2006, faqe 17.
- Theofan Popa, *Kostandin Shpataraku, piktori shqiptar i shekullit XVIII*, Nëntori, Nr. 3, 1965.
- Theofan Popa, *Piktur Kostandini prej Shpati*, Buletin për shkencat shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 211-214.
- Theofan Popa, *Ikonografët shqiptarë të shekullit XVIII*, Ngjallja, dhjetor 1995, faqe 8.

TABELA E ILUSTRIMEVE

KREU I PARË

- Fig.1. Manastiri i Llëngës
- Fig.2. Manastiri i Llëngës
- Fig.3. Afresket e pikturuara nga Kostandin Shpataraku
- Fig.4. Ikona "Shën Marina me skena"
- Fig.5. Panairi i Shën Marenës
- Fig.6. Atë Dhimitër Kokoneshi
- Fig.7. Bashkëshortët Dhimitër dhe Kostandina Kokoneshi
- Fig.8. Kokoneshi, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Pogradecit
- Fig.9. Dhimitër Kokoneshi "Qytetar Nderi" i Qarkut të Korçës

KREU I DYË

- Fig.1. Theofan Popa, Kryetar i Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve
- Fig.2. Dhimitër Beduli, Sekretar i Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve
- Fig.3. Petro Doçi, anëtar i Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve
- Fig.4. Sotir Kanxheri, anëtar i Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve
- Fig.5. "Ç'është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë".
- Fig.6. Anëtarë të lidhjes gjatë një ceremonie fetare
- Fig.7. Shkresa zyrtare ku caktohen anëtarët e delegacionit zyrtar në Bashkimin Sovjetik
- Fig.8. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik
- Fig.9. Ikonostasi i kishës Uspjesku, Moskë
- Fig.10. Vizita në muzeun e Stalingradit
- Fig.11. Intervista që dha në Patriarkanën e Rosisë, kryetari i delegacionit Paskal Vodica
- Fig.12. Kthimi i delegacionit nga Moska
- Fig.13. Kryepeshkopi Kristofor Kisi
- Fig.14. Zgjedhja e Kokoneshit anëtar i Sinodit
- Fig.15. Zgjedhja e Kokoneshit anëtar i Sinodit
- Fig.16. Episkop Irine Banushi
- Fig.17. Paisi Vodica, Kryepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë
- Fig.18. Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it, 7 shkurt të vitit 1950, në Tiranë
- Fig.19. Delegati i Durrësit, Stavrofor atë Erazmi Jorgo
- Fig.20. Delegati i Fierit Stavrofor atë Polizoi Ikonomi
- Fig.21. Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë
- Fig.22. Sinodi i Shenjtë dhe personeli. I treti nga e djathta është Vlash Nushi
- Fig.23. Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryepiskop

KREUI PARË



Fig.1. Manastiri i Llëngës



Fig.2. Manastiri i Llëngës



Fig.3. Afresket e pikturuara nga Kostandin Shpataraku




Fig.4. Ikona “Shën Marina me skena”




Fig.5. Panairi i Shën Marenës




Fig.6. Atë Dhimitër Kokoneshi



Fig.7. Bashkëshortët Dhimitër dhe Kostandina Kokoneshi



Fig.8. Kokoneshi, kryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Pogradecit



KËSHILLI I QARKUT KORÇË

I JEP TITULLIN

“ Qytetar Nderi i Qarkut Korçë”

At Dhimitër Kokoneshi

(pas vdekjes)

Me motivacionin

Për kontributin e tij të shquar në kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimit fetar ndërmjet komuniteteve të Qarkut të Korçës si dhe rritjen e autoqefalisë të kishës shqiptare.

Pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare dhe i zgjedhur në organet e pushtetit për disa vite rresht.

Sekretari i Këshillit Qarkut

ILO KOŞTANDINI

Kryetar i Këshillit Qarkut

FEHMI XHEMO

Vendimi Nr.115 dt. 23.07.2003



Fig.9.. Dhimitër Kokoneshi “Qytetar Nderi” i Qarkut të Korçës

KREUIDYTË



Fig.1. Theofan Popa, Kryetar




Fig.2. Dhimitër Beduli, Sekretar



Fig.3. Petro Doçi, anëtar



Fig.4. Sotir Kanxheri, anëtar



Fig.5. “Ç’është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë”.



Fig.6. Anëtarë të lidhjes gjatë një ceremonie fetare





KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

KRYESIA
SINODHIT TE SHENJTE

V.F.

L.F.

32

Tiranë, më 15 Dhjetor¹⁹⁴⁷

Nr. 375

Lart Shenjtërisë së Tij
Monsinjor Aleksit Patrik i Moskës
dhe i gjithë Rusisë

M o s k e

Kam nderin me i njoftue Lart Shenjtërisë s'Uaj se , tue qënd ,
fatkeqësisht , në pamundësi , për shkaqe shëndetësore , që të ndërmar
një udhëtim të gjatë me anën e ajrit dhe me gjithë dëshirën t'ime të
sijerrtë që t'Ju përshëndes personalisht ,kam ngarkuar për këtë qëllim
një delegacion kishtar të përbërë nga personat që pasojnë :

1/ Arkimandrit Paskal Vodica, drejtues dhe administrator i përgj
thëshëm i Episkopatsë së Korçës ,shef i delegacionit .

2/ Ikonon At Dhimitër Kokonecki ,klerik graduat .

3/ Ikonon At Llanar Popović ,klerik graduat .

Të gjithë pjestanë të klerik superior të Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë .

Delegacioni në fjalë është autorizuar me i transmetue ,Lart
Shenjtërisë s'Uaj dhe Sinodhit të Shenjtë të Rusisë ,n' emër të Kishës
s'onë ,përshëndetjet me respektuozë të Kishës s'onë .

Me anën e të njëjtit delegacion ,i dërgojmë Lart Shenjtërisë
s'Uaj disa kujtime kishtarë që përbëjnë një provë që qartë të inte-
resit dhe të simpatisë që Rusia kishte gjithmonë për popullin t'on
Fotografit e kambanës të Katedrales së Tiranës ,e cila është ndër-
tuar në Rusi dhe dhuruar kësaj Nishe ; fotografit e disa ikonave të
njëjtës Kishë ,vepra arti të shkëlqyeshme ,prej piktorësh rusë dhe dhur-
rata të Kishës ruse ;fotografit e Shën Aleksandër Nevakit si dhe të
zbukurimeve të brëndëshme të Kishës madhështore të Shkodrës ,e cila
nderohet n' emër të Shenjtit dhe brendija e së cilës është ndërtuar
me shpenzimet e Kishës Ruse .

Perfitojmë nga ky rast i luatur me sigurië Lart Shenjtërin t'
Uaj për devocionin e thellë që ushqejmë për Kishën e Madhe Orthodhok
të Rusisë si edhe për gjithë popullin rus ,abrojtës i math i Kombeve
të vegjël ,tek i cili popull ne shqiptarët jemi veçanërisht mirënj

./.



Fig.7. Shkresa zyrtare ku caktohen anëtarët e delegacionit zyrtar në Bashkimin Sovjetik



Fig.8. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik



Fig.9. Ikonostasi i kishës Uspjesku, Moskë



Fig.10. Vizita në muzeun e Stalingradit




Fig.11. Intervista që dha në Patriarkanën e Rosisë, kryetari i delegacionit Paskal Vodica




Fig.12. Kthimi i delegacionit nga Moska



Fig.13. Kryepeshkopi Kristofor Kisi

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

V.F. L.P. 6
Tiranë, më 15/6/1948

Nr. Prot. 178/4

Të Përndershmit
Arhimandrit Dhimitër Kokoneshi
Zëvendës i Përgjithshëm i Episkopatës së Beratit
Tiranë

Nëns cilësim t'omë si Kryetar i Sinodhit të Shënjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, në mbështetje të Vendimit unanin të Sinodhit në fjalë me datë 3/6/1948, kemi nderin t'ju njoftojmë se jini zgjedhur Anëtar i rregullt i këtij Sinodhi, me të njëjtat të drejta që gëzojnë edhe Anëtarët e tjerë, duke ju shprehur njskohësieht përgëzimet t'ona si edhe urimet e singerta që t'a kryeni me sukses e ndershmëni detyrën e shënjtë që ju bëhts besuar.

Hir'i Zotit dhe Shpëtimtarit t'omë Jisu Krisht, qoftë kurdoherë ndihmë mbë ju.

KRYETAR I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPISKOP I GJITHË SHQIPËRIË
K R I S T O P O R




Fig.14. Zgjedhja e Kokoneshit anëtar i Sinodit

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

V.F. L.P. 3
Tiranë, më 1/6/1948

Nr. Prot. 178/1

P. T.
Ministria së Drejtësisë
Tiranë

Kemi nderin t'i bëjmë të ditur Asaj P.T. Ministrije se sot përpillem dhe nënshkruam Vendimin rrelativ me zgjedhjen e të Përndershmit Arhimandrit Dhimitër Kokoneshit si Anëtar i Sinodhit të Shënjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilin po e dërgojmë sot në Korçë, që të nënshkruhet edhe nga Anëtarët e tjerë të Sinodhit në fjalë. Njskohësieht të përëndurim e nderim dhe Zëvendës të Përgjithshëm t'Episkopatës së Beratit.

Me nderime të shquara

KRYETAR I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
KRYEPISKOP I GJITHË SHQIPËRIË
K R I S T O P O R




Fig.15. Zgjedhja e Kokoneshit anëtar i Sinodit



Fig.16. Episkop Irine Banushi



Fig.17. Paisi Vodica, Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë



Fig.18. Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it, 7 shkurt të vitit 1950, në Tiranë




Fig.19. Stavrofor atë Erazmi Jorgo



Fig.20. Stavrofor atë Polizoi Ikonomi



Fig.21. Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë



Fig.22. Sinodi i Shenjtë dhe personeli. I treti nga e djathta është Vlash Nushi



Tirane, datë 14/3/ 1966

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS

KKYESIA
E
SINODHIT TË SHËNJTË

ADMINISTRATA

Nr. 24/11 Prot.

~~46/3/66~~
EPISKOPATAVE TË HIRËSHME DHE
GJITHË ZËVENDËSIVE MITROPOLITANE DHE
EPISKOPALE.--

Tirane

Q A R K O R E

Kemi nderin t'ju njoftojmë se Sinodhi i Shëntë i Kishës s'onë, në mbledhjen e tij të posaçme me datë 7 Mars 1966, vendosi unanimisht dhe zgjodhi për Kryetar të Kishës Orthodhokse Autoqefale dhe Kryepiskop të gjithë Shqipërisë, Hirësinë e tij Episkopin e Gjirokastrës Dhamiano, i cili, po në mbështetje të vendimit të lartpërmëndur të Sinodhit të Shënjtë, do të mbajë përkohësisht edhe drejtimin e Episkopatës së hirëshme të Gjirokastrës, si Ad Interim.

Duke u mbështetur në faktin e lartpërmëndur, porositen titullarët e episkopatave të hirëshme dhe titullarët e kleri mvartës i zëvendësive

•/•

Fig.23. Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryepiskop

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Parathënie.....	3
-----------------	---

KREU I PARË

Lënga, fshati i arumunëve.....	5
Manastiri i Llëngës.....	6
Panairi i Shën Marenës.....	10
Shën Marena.....	11
Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit.....	12
Prifti me kobure.....	13
Kontributi i Dhimitër Kokoneshit si drejtues i pushtetit vendor.....	15

KREU I DYTË

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve.....	16
Damjan Kokoneshi në Moskë.....	19
Dorëzimi i Paskal Vodicës dhe shkarkimi i Kisit.....	21
Kongresi III i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.....	25
Krijimi i Sinodit të Shenjtë.....	28
Fundi i Kryepeshkopit Damjan.....	32
Burime arkivore.....	35
Bibliografi.....	37
Tabela e ilustrimeve.....	40
Përmbajtja e lëndës.....	63

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Llukani, Andrea

Redaktor: Prof. dr. Hajri Shehu

Kryepeshkop Damjan Kokoneshi,/

Andrea Llukani, Tiranë: Botimet “Trifon Xhagjika”

Tiranë, 2020

64 f, 29 cm.

ISBN